

FORUM A+P 10

Periodik Shkencor për Arkitekturën dhe Planifikimin Urban

2012

Tirana dhe Imagjinata Urbane Nga gjenezat tek modeli metropolitan

Tirana dhe Imagjinata Urbane

FORUM A+P 10



Kontakt:

Rr. Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar
 KP 2995, Tirana Albania
 Tel:+ 355.(0)4.24074 - 20 / 21
 Fax:+ 355.(0)4.2407422
 Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881
 forum_ap@universitetipolis.edu.al

Ky numër u mundësua nga Universiteti POLIS & Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit

Falenderim i veçantë për:

SCP, Swiss Cultural Programme dhe Bashkinë e Tiranës



swiss cultural programme
 in the western balkans



Këshilli i Redaksional: Dr. Peter Nientied (Holandë)
 Dr. Vera Bushati
 Dr. Besnik Aliaj
 Dr. Arben Shtylla
 Dr. Gëzim Qëndro
 Prof. Thoma Thomai
 Prof. Dr. Vezir Muharremaj
 Dr. Loris Rossi (Itali)
 Dr. Antonino Di Raimo (Itali)
 MND. Ark. Doris Andoni
 MND. Ark. Sotir Dhamo
 MND. Ing. Dritan Shutina
 MND. Ark. Rudina Toto

Konsulentë: Ark. Artan Raca
 Ark. Kristi Andoni

Drejtor: Dr. Besnik Aliaj

Kryeredaktor: MND. Sotir Dhamo

Redaktor letrar: Prof. Naim Balla
 Ketil Sula
 Isela Janka

Redaktoi në Anglisht: Kleitia Vaso

Art Design / Layout: Sonia Jojic

Shtypur nga: botime afrojditi

Përmbajtja

Editorial

Tirana dhe roli i "imagjinatës urbane" në transformimin e saj.

Nga gjenezat tek modeli metropolitan

Sotir Dhamo4

Forum Albania

Edhe njëherë për Projektin "Ti-Rama"

Besnik Aliaj66

Për çfarë duhet një arkitekt ?!

Elvan Dajko90

Vilat e Tiranës në harkun kohor midis dy luftërave botërore

Dr.Vera Bushati & Ernest Shtëpani132

The "Greater" Balkan City

Elona Karafili142

Shkëmbime Sub-Urbane

Mikro ndërhyrje për të rivitalizuar qytetet bashkëkohore në ballkan

Ledian Bregasi154

An architecture without architects

The self-organized parasite organisms in the architecture of the city of Tirana

Ledian Bregasi164

T[ir]/[ar][a] [ha] [na] City

"Branding" the new image of Tirana

Eno Barjami176

Kopertina: Toptani Centre i © MVRDV dhe KM Runaway Park i © ATENASTUDIO



Unioni Shqiptar i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve mbështetur në parimin e përparimit të arkitekturës e të ngritjes së nivelit profesional e shkencor, përfaqëson këtë komunitet me një zë kritik e alternativ duke ofruar shërbime profesionale dhe ligjore. Për anëtarësimet si dhe për informacinin e plotë mbi shërbimet e ofrura nga Unioni Shqiptar i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve ju lutemi kontaktoni me

AUA

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5,
 Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995, Tirana, Albania
 Tel: + 355(0) 4 2407420 / 2407421
 Fax: + 355(0) 4 2407422

+ Konferenca Shkencore Ndërkombëtare

+ Konkurse Ndërkombëtare

+ Ekspozita

+ Workshop

+ www.unioniarkitekteve.org





“Forum A+P 10” mund të konsiderohet një speciale për Tiranën, përmbledhje unike, që synon të sjellë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse reflektime mbi projekte dhe ide jo vetëm të shkallës urbane, por edhe arkitektonike. Tirana trajtohet në evolucionin e saj si vendbanim që nga themelimi e deri në konkurset ndërkombëtare të kohëve të fundit, që synojnë ta kthejnë Tiranën në një kryeqytet të konkurueshëm në rajon. Sikurse në çdo qytet tjetër edhe në Tiranë “imagjinata urbane” është pjesë e zhvillimit të qytetit, imagjinatë kjo që krijohet si nga arkitektët e urbanistët, apo elitat intelektuale, ashtu edhe nga njerëzit e thjeshtë. Për këtë arsye është e nevojshme që analizat e qytetit, të shihen edhe në këndvështrimin e eksperiencave teorike kolektive, që i kanë dhënë nxitje kapërcimeve cilësore të zhvillimit të qytetit në momente të caktuara të historisë. Në këtë këndvështrim, ky numër special synon të tejkalojë radhitjen e zakonshme

të projekteve të hartuara për Tiranën (gjë që në mënyrë pjesore është bërë edhe përmes botimeve të tjera) dhe mbi të gjitha synon të sjellë analiza dhe reflektime, të cilat mendojmë se janë të vlefshme për të krijuar një kulturë të re edhe në Shqipëri në mënyrën se si trajtohet trashëgimia jo vetëm e ndërtuar, por edhe ajo e mendimeve të hedhura për zhvillimin e qytetit. Ky numër, i cili trajton projektet e konkurseve deri në vitin 2011 do të ndiqet nga një speciale tjetër i “Forum A+P”, i cili do të trajtojë sfidat dhe konkurset në vazhdim për qytetin e Tiranës. Për të bërë të mundshëm këtë dokumentim i jemi referuar publikimeve të siteve publike të Bashkisë së Tiranës si edhe mediave të tjera. Publikimi i kësaj reviste nuk bëhet për qëllime përfitimi, por për qëllime të mirëfillta shkencore si dhe për të garantuar të drejtën e informimit publik dhe të transparencës ndaj rretheve akademike, profesionale e më gjerë.

Abstract

This special edition focused on Tirana is a reflection on some of the most important projects for the city's transformation, a process which started at the beginning of the last century and is still continuing. A particular focus is placed on the projects presented during the period 2004-2011 regarding architecture and urban planning. Most importantly, this issue is not merely a summary of projects but an attempt to see Tirana's evolutionary process, from its beginnings to the "Greater Tirana and the current phase of international competitions aiming to transform Tirana into a competitive city in the Balkan region. This article highlights the fact that, differently from what many people believe, Tirana is not lacking in projects or ideas but rather concrete actions needed to implement projects and guarantee continuity based on a mid to long term vision. As we can see from the article, "urban imagination" which includes ideas coming not only from architects and planners but also from ordinary people, played an important role in Tirana's shape as a physical and "celestial" / ideal structure. This makes Tirana a city "moving" between dreams and reality, a "shift" which is an important generator for the city's existence and transformation ... from "agricultural fields" to the urban "cosmic axes" of the boulevard, from concentric rings to the "archipelago city", from a solely spontaneous to also a designed/structured city, from dictatorial interventions to self-made incremental housing and neighborhoods, from "Tirana" to "Durana", from small to big. In order to better position Tirana in its historical process, it has been useful to analyze it also from the perspective of the collective experiences which along history triggered qualitative improvements in a global scale and created the base for the development of new urban civilizations. This is vitally important in our days when cities in the global arena are facing new challenges due to environmental and energy crises. This context encompasses new challenges. What will the Tirana of the future look like? Towards which version of "Tirana" are we heading? Are we ready to undertake a new and daring leap? Hopefully, the overview presented in this article and in this special edition in general, can offer a modest contribution to these questions. Finally, this issue is also a contribution to the information on important issues of Tirana's development pertaining to professional circles as well as the public in general.



Tirana dhe roli i "imagjinatës urbane" në transformimin e saj.

Nga gjenezat tek modeli metropolitan

Sotir Dhamo

Hyrje

Ky artikull synon të sjellë argumente në lidhje me përgjigjen e pyetjes "përse dhe si qytetet kanë marrë formën që ne shohim sot" dhe e ilustron këtë me rastin e Tiranës. Shumë qytete përmbajnë brenda vetes bashkëveprimin e forcave të spontaneitetit vetëkrijues, me ato të themelimit e të "ritthemelimeve" të herë-pas-hershme. Si është përcjellë dhe si ka evoluar tensioni i këtij bashkëveprimi brenda pëlhurave urbane, këto janë çështje që i kam trajtuar në artikullin e Forum A+P 5¹. Në dallim, ky artikull trajton efektin e ndërhyrjeve të planifikura, të quajtura gjatë artikullit si "ritthemelime", në skeletin tërësor të qytetit dhe në vizionet për drejtime të reja zhvillimi. Për këtë artikulli synon të hyjë më thellë

1 Ky artikull mund të konsiderohet si pjesa e dytë e artikullit "Qyteti, tërësia që përmban dialektikën e "vetë krijimit": Midis morfologjisë së kaosit dhe të rregullit", i botuar në Forum A+P 5, shtator 2010.

në "të vërtetën" e Tiranës, duke analizuar raportin e qytetit organik me ndërhyrjet e planifikuara, jo thjesht duke renditur planet apo projektet nga viti 1920 e deri më sot, por duke u përpjekur të evidentojë rrishtë konceptuale dhe metodologjike të sjella nga to, përfshirë edhe projekte të mbetura në tentativë por që synuan të sjellin diçka të re. Të kuptuarit e këtij bashkëveprimi si edhe e "memorieve të rithemelimeve", është pjesë e rëndësishme e strategjive të dizajnit e planifikimit urban të bazuara në cilësitë e brendshme të vetë qytetit. Kështu, artikulli është një përpjekje për ta parë formimin dhe transformimin e Tiranës si pasojë e këtij bashkëveprimi në harkun kohor të 90-100 viteve të fundit që nga themelimi, transformimet e para gjatë mbretërisë, periudhës së ndërtimit socialist, postsocialist dhe postkaotik, në se atë të sotmen me optimizëm mund ta quajmë të tillë. Artikulli synon gjithashtu të tregojë se në ditët e



Sotir Dhamo is an architect and urban planner with a great deal of experience in the fields of design and urban planning. He is also the author of several research studies conducted by the Institute of Architecture and Urban Planning, the Ministry of Public Work and Territory Regulation, Co-Plan, the Institute for Habitat Development, etc. Sotir is one of the founders of POLIS University, the International School of Architecture and Urban Development Policies in Tirana. In addition, he has earned a Master's degree in Public Administration from the Syracuse University, NY. Currently, he is a lecturer of Urban Analyses and Urban Design at Polis University, a course with a particular focus on space transformation and development at an urban and territorial level.

Sotir Dhamo është arkitekt urbanist me eksperiencë të gjerë profesionale në fushën e dizajnit dhe planifikimit urban, autor i disa studimeve që fillojnë nga Instituti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit, Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, etj. Është një nga bashkëthemeluesit e drejtuesit e Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban në Tiranë. Ai mban gjithashtu gradën "Master" në Administrim Publik të fituar në SHBA në universitetin e Syracuses, NY. Aktualisht është edhe lektor i lëndës së Analizave Urbane dhe Dizajnit Urban në Universitetin POLIS me fokus të veçantë transformimet dhe zhvillimet e hapësirës në nivel urban dhe territorial.

sotme suksesi i qendrave urbane dhe garantimi i së ardhmes së tyre qëndron së pari në të kuptuarit pa komplekse të “vetvetes” dhe se “zgjdhjet” e situatave si ato të Tiranës nuk “qëndrojnë” më vetëm në shkallën urbane, por edhe në eksplorimin e modeleve, që pozicionojnë qytetin në një shkallë të re hapësinore, atë të rajonit metropolitan dhe rrjetave të ndërveprimit.

Ky punim fillon me sjelljen e disa mendimeve alternative lidhur me raportet midis “themelimit” dhe “spontaneitetit” të fillesave të Tiranës. Artikulli e sheh këtë jo kaq shumë nga këndvështrimi i analizave historike të themelimit të bërthamave të para, çështje këto të trajtuara nga autorë të tjerë të referuar në artikull, por nga pikëpamja e ndërveprimit të vazhdueshëm të këtyre “dy qyteteve”. Nisur nga kjo premisë artikulli shtron pyetjen: A mundet njeriu të drejtojë zhvillimin e qyteteve përmes “imaginatës urbane” të përfaqësuar në modele, plane, projekte e dëshira njerëzore? Shtjellimi i kësaj pyetjeje synon të tregojë rëndësinë e kësaj “imagine” si në rafshin teorik, ashtu edhe në zhvillimin real të qytetit; dhe më konkretisht të Tiranës midis ëndrrës dhe realitetit.

Në këtë logjikë, artikulli synon të argumentojë se ndryshe nga sa mendohet që Tiranës i mungojnë planet dhe idetë për zhvillim, e kundërta është e verteta: Tirana mbart një pasuri mendimesh e projektsh të publikuara e të papublikuara, të cilat janë një burim që ende duhet eksploruar. Tiranës i kanë munguar veprimet, sidomos vazhdimësia e veprimeve të ndërmarra mbi bazën e një vizioni afatgjatë. Shumë energji mendore, intelektuale dhe monetare është shpenzuar për këtë “thesar”, që admini-

strat e kanë nënvleftësuar. Ky artikull dhe ky numër i Forum A+P 5 synon të japë një kontribut intelektual në dokumentimin e kësaj energjie.

Nga ëndrra e Sulejman Pashës tek “Tirana e Madhe”

A është Tirana qytet i Themeluar apo spontan? Sipas Kostov S. (2003)², ekzistojnë dy tradita lidhur me formimin e qyteteve; modeli hyjnor dhe ai me iniciativën e njerëzve të zakonshëm. Mbi themelimin e bërthamës së parë të Tiranës informacioni kryesor na vjen nga legjenda, e cila mbart elementet simbolike të themelimit. Variantet e kësaj legjende si edhe baza e vërtetësisë së elementëve kryesore janë përshkruar dhe analizuar gjerësisht në librin “Historia e Tiranës”³ e K. Frashërit (2004). Ndërsa proceset urbanistike të lindjes së disa bërthamave në mënyrë të pavarur, pozicionimi dhe shkrirja e tyre në një “masë” të vetme përshkruhen më së miri në librin “Tirana-Sfida e zhvillimit urban”⁴ nga Aliaj B. etj. (2003). Kjo ide e lindjes së bërthamave me përmbajtje dhe qëllime specifike (“Wakf”, shërbime, ekonomi dhe administrim) është parë edhe në këndvështrimin e themelimit të Tiranës si rrjedhojë e proceseve qytetpërhapëse të Perandorisë Otomane të kohës. Kjo pasqyrohet nga Laze A. (2009)

2 Kostov Spiro, “The city shaped – urban patterns and meanings through history”, fq. 29-37, Bulfinch press, Boston, New York, London, 2003.

3 Frashëri Kristo, “Historia e Tiranës si qytet deri më 1920” vëllimi 1, fq. 54-66, Botimet Toena, 2004

4 Aliaj Besnik, Lulo Kejda, Myftiu Genc, “Tirana -Sfida e Zhvillimit Urban”, fq. 16-18, botues GVG, Tiranë 2003.

në artikullin e Forum A+P 1⁵.

Sikurse shkruan Kostov⁶, Historia njeh shembuj që qytete të reja fillojnë epoka të reja. Këto lloj qytetesh quhen ndryshe edhe qytete “të themeluara”. Në shumë kultura antike, qyteti mbi tokë supozohej të përfaqësonte një model hyjnor, i cili duhet të kishte disa cilësi, si shtrirje gjeometrikisht të pastër, orientim sipas pikave të horizontit, porta hyrëse simetrike, dimensionet dhe numrat magjike. Nga ana tjetër, ka ekzistuar edhe një “kundertraditë” që ka të bëjë me urbanizimin me iniciativën e njerëzve të zakonshëm, gjë për të cilën zotat nuk ishin të kënaqur. Krijimi i qyteteve nga vullneti i njerëzve interpretohet si anashkalimi i autoriteteve. Por edhe në këtë rast ato nuk janë rezultat vetëm i procesualitetit dhe kushteve gjeomorfologjike: në një moment të caktuar qytet-formimi gjithmonë mbart një akt vullneti të një lideri apo kolektiviteti (Kostov S, 2003).

Në historinë e vendbanimit të Tiranës, legjenda e themelimit jep elementët fillestarë të krijimit të qytetit (1614). Ky moment ka të bëjë më shumë me aktin simbolik të krijimit, se sa me aktin administrativ të planifikimit, në kuptimin e konfigurimit të rregullit hyjnor mbi tokë. Sikurse pohohet në librin e K. Frashërit (2004), “Historia e Tiranës”⁷, ekzistojnë disa variante të legjendës dhe disa prej tyre, si ajo e J. G. Von Han-it, pranojnë faktin se përpara the-

5 Laze Alban, 1614 – “Kulliye” e Tiranës fillesa e nje metropolis”, artikull tek periodiku shkencor i Universitetit POLIS, Forum A+P1, botues Aliaj B. Dharmo S. Shutina D. Tiranë 2009

6 Kostov Spiro, vepra e cituar më sipër, fq. 29-37.


7 Frashëri Kristo, vepra e cituar më sipër, fq. 54.

melimit ekzistonte një fshat i vogël me 15 shtëpi. Pa dashur të përmendim të gjitha variantet dhe detajet e legjendës, do të sjellim këtu vetëm ato që na interesojnë për këtë shkrim. Po sipas K. Frashërit⁸, elementët e legjendës që i përgjigjen së vërtetës janë personazhi i Sulejman Pashë Bargjinit si edhe ndërtimet që i atribuohen atij: Xhamia e Vjetër (shembur në Nëntor 1944), (seria e figurave 1) furra dhe hamami disa metra në perëndim të xhamisë (shembur më 1938) dhe hani pranë tyre (shembur më 1958). Pra, më 1614 me ndërtimin e këtyre objekteve të cilat nënkuptonin fillimin e një tregu, fshati i Tiranës filloi rrugën e shndërrimit drejt qytetit. Interesant është se në variantin e legjendës sipas A. Degrandit, Sulejman Pashë Bargjini shtie në dorë truallin për ndërtimin e katër objekteve të përmendura më sipër me dhunë, e me dredhi duke përfutuar edhe prej miqve të tij në Stamboll. Në këndvështrimin tonë, ky variant përmban në vetvete elementet e para të spontaneitetit që duket se kthehen në dukuri kronike për historinë e mëpasme të Tiranës.

Kur Sulejman Pasha kalonte përmes vendit ku më vonë u ngrit Tirana, admironte bukuritë e pyllit plot ujëra që rridhnin në këtë fushë të hapur. Sulejmani i tërhequr nga kjo bukuri e natyrës vendosi të shpërngulej nga Mulleti, të vendosej në këtë vend e të themelonte një qytet. Por fusha me pyllin dhe ujërat ishin pronë e një feudali tjetër i shpërngulur prej kohësh nga Peqini dhe i vendosur në kullën e tij në Selitë pranë fshatit Sauk. Pasi Sulejman Pashë Bargjini kishte kërkuar disa herë ta blinte me të holla këtë fushë me pyll dhe pasi feudali tjetër nuk kishte pranuar,

8 Frashëri Kristo, vepra e cituar më sipër, fq. 57-60.

Seria e figurave 1: Bërthama qendrore dhe transformimi i saj
(përpunimi grafik nga Elios Kovaçi)



Bërthama e parë qendrore në kryqëzimin e flukseve rajonale dhe lokale: Elbasani, Shën Gjergji, Durrësi, Dibra, Shkodra dhe Kavaja, Xhamia e Vjetër dhe raporti me qytetin që do të vinte më pas (1614)



Bërthama e "Xhamisë së Vjetër", "Pazarit të Vjetër", "Xhamisë së Et'hem Beut" dhe krijimi i sheshit të Ministrive (harta bazë, 1937)



Spostimi i rëndësisë së qendrës nga sheshi i "Xhamisë së Vjetër" tek "Sheshi i Ministrive"



Artikulimi formal i ndërtimeve të "Pazarit të Vjetër" me ato të ndërtimeve të reja të ministrive. Xhamia e Et'hem Beut luan rolin rakordues në pikën kyç të infleksionit dhe lidhet nga pikëpamja perceptimore dhe fizike me sheshin e "Xhamisë së Vjetër".



"zgavra" e mbetur në hapësirën qendrore pas shembjeve të bërthamës së Pazarit të Vjetër. Krijimi i sfondit për Pallatin e Kulturës, hotel "Tiranën" dhe Muzeun Kombëtar.



5 Xhamia e Et'hem Beut e inkuadruar në projektin e sheshit të ministrive në periudhën e mbretit Zog (pamje e vitit 1937)
6 Transformimi i sheshit në sheshin "Skënderbej" pas prishjes së "Pazarit të Vjetër", ndërtesës së Bashkisë së vjetër dhe të një rrjeti ndërtesash të lidhura me to; ndërtimi i "Pallatit të Kulturës", hotel "Tiranës", "Muzeut Historik Kombëtar" dhe risistemimi i sheshit gjatë periudhës së fundit të komunizmit (pamje e viteve '80)



- 1 Xhamia e Vjetër
- 2 Kulla e Sahatit dhe Xhamia e Vjetër në sfond
- 3 Xhamia e Et'hem Beut, Pazarit të Vjetër dhe Xhamia e Vjetër në sfond
- 4 Xhamia e Et'hem Beut dhe sheshi përpara në ditë pazari



Sulejman Pashë Bargjini si më i fuqishëm nga pozita e nga miqtë në Stamboll vendosi të përdorte dhunën: urdhëroi të pritej qeresteja në pyll dhe të hidheshin themelet për ndërtimin e xhamisë e të furrës. Filloi kështu konflikti midis të dyve dhe beu, i cili e konsideronte veten pronar legjitim të këtij vendi, sulmoi muratorët dhe rrafshoi muret e xhamisë. Kjo mjaftoi që Sulejman Pasha, duke mos zënë në gojë fajin e tij si grabitës, të padiste beun për sakrilegi ndaj xhamisë dhe mbi këtë bazë gjyqi i lartë i Stambollit e dënoi atë me vdekje. Kështu, Sulejman Pasha mundi të përfundojë ndërtimin e godinave të filluara⁹.

Duket se fill pas këtij momenti do të vinin edhe elementet e para të spontaneitetit. Sikurse pohon edhe Dom Mark Dushi¹⁰ në librin "Tirana dhe rrethinat e saj", rreth xhamisë, furrës dhe hamamit u shtuan ndërtesa sa për të krijuar një fshat apo një qytet të vogël. Më tej Tirana u rrit në fomën e një vendbanimi me strukturë organike të shtrirë pa ndihmën e ndonjë projekti paraprak. Xhamitë luajtën një rol të rëndësishëm për krijimin e 5-6 bërthamave⁹

⁹ Frashëri Kristo, *legjenda sipas Konsullit Frëng në Shkodër, A. Dëgrand, vepra e cituar më sipër, fq. 56-57.*

¹⁰ Dom Mark Dushi, *Tirana dhe Rrethinat e saj, fq. 32, Botimet Toena, Tirane 2005.*

mave të para urbane të Tiranës mbi bazën e fiseve të ndryshme, të cilat u rritën gradualisht dhe u bashkuan. Me siluetën e tyre ato i jepnin Tiranës një identitet krejt të veçantë. Kjo përshkruhet më së miri në librin "Tirana- Sfida e Zhvillimit Urban"¹¹ (Aliaj B. etj. 2003). Sikurse pohohet në këtë libër, bërthama e parë e qytetit të Tiranës lidhej me Xhaminë e Vjetër të Sulejman Pashës, në kryqëzimin e trajektoreve gjeneruese rajonale. Bashkë me xhaminë u shtuan edhe banesa të feudalëve dhe të të afërmeve të tyre në bregun e djathtë të përroit të Lanës. Furrë, hamami, hani dhe pazari së bashku me banesat, oborret, rrugicat, sheshet dhe varrezat, të grupuara rreth xhamisë formonin një njësi sociologjike me lidhje familjare dhe pronësie. Bërthama e dytë e ndërtuar rreth Xhamisë së Fires (pas rindërtimit u quajt e Beshirit), u krijua rreth 600 m në veriperëndim të së parës. Bërthama e tretë u formua rreth xhamisë së Zajmit (1755) në verilindje të së parës, e katërta rreth Xhamisë së Haxhi Et'hemit 200 m në perëndim të bërthamës së parë. (Aliaj, B. etj.)

Bazuar në interpretimin e analizave

¹¹ Aliaj Besnik, *Lulo Kejda, Myftiu Genc, vepra e cituar më sipër, fq. 16-18.*

të S. Kostov mbi qytetin Ballkanik, A. Laze¹² vjen në hipotezën se formimi i qytetit të Tiranës është pasojë e veprimit të programuar të institucionit të "Waqf" gjatë periudhës klasike Otomane. Ky institucion fizikisht përfaqësohej nga "kulliye" e cila përcaktohej nga një kompleks godinash dhe territori ku ato ndodheshin. Përveçse një institucion "waqf", "kulliye", ishin edhe një kompleks urban, që përmbante xhaminë e cila dominonte dhe gruponte ndërtimet e tjera. Kategoritë e përdorimit të tokës në "waqf" si shërbime, ekonomi dhe administrim përcaktonin funksionet e "kulliye"-ve. Në këtë version të themelimit të qytetit të Tiranës jemi më pranë idesë së themelimit të bazuar në politika administrative të caktuara. (Seria e Figurave 2).

Rritja e pavarur e këtyre bërthamave u "shkri" në një strukturë organike ekstensive me oborre të mëdha. Elementi ndarës i strukturës ishin hapësirat private të "qelizave" të banimit dhe jo rruga si hapësirë publike. Vendosja e "qelizave" përsë parë.

¹² Laze Alban, 1614 – "Kulliye" e Tiranës fillesa e një metropolis", artikull tek periodiku shkencor i Universitetit POLIS, Forum A+P1, botues Aliaj B. Dharmo S. Shutina D. Tiranë 2009.

caktonte hapësirat e komunikimit dhe jo anasjellas. Kjo vinte për faktin se mbyllja e "qelizave", të konceptuara mbi bazën e fqinjësisë, ishte më e rëndësishme se hapja apo përshkueshmëria. E njëjta situatë reflektohet edhe tek hapësirat gjysmë private të formuara nga një sistem rrugësh pa krye, të cilat i takonin vetëm një grupi banorësh. Principi i devijimit të rrugës dhe jo perspektivat e gjata të hapura garantonin intimitetin. Kjo strukturë gjendet akoma sot në një pjesë të Tiranës lindore (Seria e figurave 3: krahasimi i gjenerimit të qytetit organik dhe të planifikuar, "Lagja Dibrane" dhe "Tirana e Re").


Përpjekjet për t'i dhënë "formë" dhe "referenca" të reja këtij organizmi të krijuar dhe rritur në mënyrë spontane, filluan në periudhën e mbretërisë me projektet për sheshin qendror të ministrive dhe vazhduan më tej gjatë pushtimit italian me projektet për bulevardin qendror dhe disa prej ndërtimeve kryesore përgjatë tij. Pas viteve '20 të shekullit të kaluar kur Tirana u shpall kryeqytet nisën edhe "dyndjet" e para, fenomen ky që do të kthehej në dukuri kronike deri në fund të viteve '30 ishin projektet e pjesshme, por në shkallë

Pamje lindore e Tiranës dhe "Pazarit të Vjetër" në vitin 1937

Seria e figurave 2


Rritja e Tiranës si një vendbanim me strukturë organike dhe roli i xhamive në krijimin e bërthamave të para sipas sistemit të kullmeve.

Harta e Tiranës në vitin 1921 sipas Skënder Frashërit



Seria e figurave 3: Krahasimi i gjenerimit të qytetit organik dhe të planifikuar, lagja "Dibrane" dhe "Tirana e Re" (përpunimi grafik nga Elios Kovaçi)


■ Skemë agregimi të njësive tipologjike në lagjen "Dibrane" ("organike")



| Situata bosh-plot dhe trajektoret


Faza të rritjes së njësive në raport me trajektoret. Rritja e intensitetit të ngjyrës tregon plotësimin e strukturës sipas fazave. "Zemra" qendrore plotësohet e fundit dhe kjo shkakton tërheqjen e itinerareve të zgjatura fundore me degëzime anësore në formë xhepush.

■ Skemë agregimi të njësive tipologjike në "Lagje të Tiranës së Re" (e planifikuar)



| Situata bosh-plot dhe trajektoret

Plotësimi i njësive në raport me trajektoret sipas niveleve të qarta të hierarkisë së projektuar. Vendosja e banesave në radhë sipas një strukture me perspektiva të hapura dhe të ndërlidhura (jo fundore)



| Struktura historike që ende ekziston në trupin e Tiranës.



| Rezultati i hapësirës kolektive dhe private sipas "agregimit labirint", (organike)

Karakteristikat e gjenerimit të njësive të banimit në lagjen "Dibrane" të Tiranës bazuar në hartën e vitin 1937. Principet e krijimit të labirintit dhe të "rugicave qorre": nënndarja e strukturës fillonte nga vendosja e hapësirave private të "qelizave" të banimit. Ishin këto që përcaktonte hapësirat e komunikimit në sipërfaqet e mbetura dhe jo rrugët si përcaktuese të hapësirave publike. Mbyllja e "qelizave" ishte më e rëndësishme se hapja; devijimet dhe jo perspektivat e hapura garantonin intimitetin.



| Rezultati i hapësirës kolektive dhe private sipas "agregimit me perspektiva të hapura" (e planifikuar)



të madhe, ato që drejtuan transformimet e qytetit: drejtimi i rrugës së Durrësit, sheshi i ministrive dhe ministritë, kompleksi “dopo lavoro”, “Tirana e Re”, sistemimi i Lanës, zona banimi përgjatë Lanës etj. Këto projekte si edhe një vizion më i gjerë për Tiranën u përfshinë në planin e vitit 1942.

Projektet vazhduan gjatë regjimit komunist me përpjekjet për t'i dhënë një dimension dhe imazh të ri qytetit, duke filluar që nga tjetërsimi i qendrës historike të Tiranës e deri tek ndërhyrjet në masë për krijimin e zonave të reja të banimit dhe atyre të punës (zonave industriale) përreth qytetit. Në kushtet e ekonomisë së centralizuar rritja e qytetit bëhej krejtësisht e kontrolluar mbi bazën e instrumentit “plan rregullues”. Pati dy të tilla gjatë periudhës '44-'90. Pavarësisht që parashikimet bëheshin në shkallë të përgjithshme të qytetit, shumë vendime si psh., prishja masive e zonave tradicionale, kanë qenë me efekte të pariparueshme për Tiranën. Mungesa e pronësisë mbi tokën e lehtësonte vendimarrjen dhe zbatimin e projekteve në territore të gjera, me ndërtime jo më të larta se 4-5 kate dhe me hapësira të bollshme midis tyre; sikurse edhe krijimin e hapësirave publike me sipërfaqe të konsiderueshme në shkallë qyteti, siç ishte “parku i liqenit” etj.

Kjo tendencë e rritjes së qytetit të bazuar në plane paraprake, pothuajse ndryshoi krejtësisht pas viteve '90 kur qyteti rritej ose në mënyrë spontane, ose mbi bazën e sheshit të ndërtimit apo operacioneve pjesore riparuese të palidhura me njëra-tjetrën. Kjo mënyrë që vazhdonte të mos merrte parasysh “leximin” e indeve të qytetit dhe që cenonte interesin publik ndryshoi ndjeshëm morfologjinë e gjithë qytetit. Ti-

rana fitoi spontanisht një dimension të ri dhe përsëri u kthye të ishte më shumë pre e spontanitetit njerëzor sesa ndërhyrjeve të planifikuara.

Në përpjekjet pas viteve 2000 vihet re një tendencë për të krijuar vizione në një shkallë që tekalon “kufijtë” tradicionale dhe synon të ravijëzojë rajonin metropolitan të Tiranës. Të tilla mund të konsiderohen idetë mbi “Tiranën e madhe”, Tiranën si “qytet arqipelag”, “Tiranën Paralele” apo “Duranën”. Por mentaliteti profesional dhe ai administrativ nuk ka qenë në gjendje të absorbojë dhe aq më shumë të ndjekë zbatimin e këtyre vizioneve. Duke dështuar në aftësitë vizionare dhe në formulimin e zbatimin e planeve në shkallë gjithëpërfshirëse, duket se në mënyrë sistematike Tirana e periudhës pas viteve 2004-2005 pati disa projekte pjesore, të cilat u dukën se për momentin pikëpoqën më mirë interesat e administratave; siç kanë qenë masterplani i qendrës, projektet për disa zona prioritare zhvillimi, projekti për sheshin qendror të Tiranës etj. Pavarësisht risive konceptuale, apo provokimit që këto projekte sollën në rrafshin profesional, në raport me realizimet e tyre në terren këto projekte i ngjasojnë përdorimit të “bllofit” për të grumbulluar kredite në “lojën” me qytetarët.

Siç tregon materiali në vijim, duke filluar nga viti 1942 e deri më sot, Tirana pati disa tentativa për të hartuar plane rregulluese të përgjithshme. Disa prej tyre mbetën në tentativë ose mundën të hyjnë në veprim më vonë nga parashikimet, disa të tjera nuk mundën të shohin kurrë miratimin e tyre. Këto plane tentonin të “ndiqnin” rritjen e qytetit dhe njëkohësisht t'i jepnin fillësë pjesëve që “themeloheshin” nga e para.

Tentativat për plane e projekte për Tiranën tregojnë ndër të tjera edhe përpjekjen e vazhduar për të përputhur “botën ideale” me mundësitë reale, si pjesë e pandarë e zhvillimit të çdo qyteti.

Midis “imagjinatës urbane”, sfond historik.

Aspiratat e njeriut në lidhje me formën e vendbanimit kanë gjetur shprehje gjatë historisë tek modelet “ideale” ku përfaqësohen si aspiratat, ashtu edhe elementet e realitetit; përpjekjet e vazhdueshme për të vendosur “rregull”. Në momente krizash urbane, këto modele, shumë prej të cilave ideojnë forma të reja civilizimi të përkthyer në hapësirë, kanë qenë nxitësit për të kaluar drejt situatave të reja.

Sfondi teoriko-filozofik i këtij rrugëtimi midis adhurimit të botës ideale dhe veprimit për ndryshim përshkruhet mjaft mire në librin “Colage City”¹³ të autorëve C. Rowe dhe F. Koetter (1978). Përmbledhtas ata argumentojnë se ekzistojnë dy histori në lidhje me qytetin: “Utopia klasike”, qyteti i mendjes dhe “utopia aktiviste”, pjesë e aksionit politik. E para kishte të bënte me adhurimin e objekteve dhe nuk ishte një instrument politik. Ajo ishte e frymëzuar nga morali universal racional dhe idetë e së drejtës. Vizioni i saj bazohej midis “Timaeus” dhe “Jerusalem të Ri” (City of God, Celestial) dhe “vdiq” përpara Revolucionit Francez. “Timaeus” i Platos mbi rregullin kozmik jepte koncepte filozofike mi-

¹³ Rowe Colin, Koetter Fred (1978), “Collage city”, kapitulli: utopia: decline and fall?, fq. 9-31, The MIT Press, Cambridge, Massachusetts and London, England (tenth printing 2001).

stike mbi numrat dhe figurat gjeometrike, të cilat paraqitnin të vetmin realitet të vërtetë. Ai flet për perfeksionin e formave trekëndore, kuadrate dhe rrethore, si në orbitat qiellore e botën e kristaleve – të vërtetën e përjetshme e të pandryshueshme, të cilën njeriu vetëm mund ta adhuronte. Në këtë aspekt rezultati arkitektonik i “qytetit ideal” ishte një pjesë e utopisë, emblemë e së mirës sipërore dhe universale, një e ardhme hipotetike për t'u adhuruar si qëllim në vetvete. Edhe pse ky përdorej më shumë si imazh krijoi principe për formën e qyteteve. Utopia aktiviste filloi pas Iluminizmit. Ushqimi për të ishte racionalizmi njutonian i cili solli një këndvështrim të ri lidhur me ndërtimin racional të botës fizike. Shkenca ishte e vërteta dhe bota materiale u bë e shpjegueshme. Në këto rrethana lindi pyetja në se mund të përdorej shkenca si lexim i saktë edhe i shoqërisë. Këto shërbyen si premisa për të kaluar nga ndërtimi racional i botës fizike tek idetë për shoqërinë rationale dhe rinovim social, nga “qyteti vetëm për t'u adhuruar” tek qyteti i “prekshëm” dhe pjesë e aksionit politik. Kështu, nga utopia klasike u kalua tek utopia aktiviste; nga racionalizmi njutonian ku gjithçka ishte e saktë dhe shkencore, tek Saint Simon mbi shoqërinë rationale përmes përkthimit të politikës në çështje të fizikës, ku shkenca mbi njerëzit (sociale) do të tejkaloonte hamendësimet. Ndërsa koncepti i dialektikës historike të Hegel-it mund të shpjegonte shoqërinë përmes historisë. Në se historia duhet të jetë rationale pasionet dhe dëshirat njerëzore janë instrumente të ndryshimit të Shpirtit të Botës. Për këta të fundit bota shpirtërore ishte më e rëndësishmja; ajo fizike ishte e ndërvarur prej saj. Ky sfond teoriko-filozo-

fik pati një impakt të madh mbi produktin arkitektonik dhe urban që erdhi më pas (Rowe C., Koetter F. 1978).

Mundësitë e lëvizjes sipas teknologjive dhe burimeve natyrore të reja në shekujt XIX dhe XX, e “shpërthyen” formën kompakte të qytetit, duke krijuar dinamika të reja të transformimeve të brendshme dhe duke e vendosur njeriun në raport me një territor shumë më të gjerë. Framton K. (1993) në librin “Historia e Arkitekturës Moderne”¹⁴ përshkruan transformimin gjatë periudhës së industrializimit, nga qyteti tradicional kompakt dhe i rrethuar me mure drejt rajonit metropolitan me shtrirje të vazhdueshme. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit të forcave teknike dhe atyre sociale-ekonomike gjë që solli shembjen e bastioneve dhe shtrirjen e qyteteve përtej mureve. Londra, Parisi, Barcelona, Chicago, ishin disa nga qytetet kryesore të kësaj periudhe. Kjo shtronte nevojën për alternativa të reja të formës së qytetit dhe të shpërndarjes së burimeve njerëzore në territor.

Hipotezat e reja lidhur me këto alternativa mund t’i shohim në disa këndvështrime:

Ato shprehin në radhë të parë “kompleksin e çlirimit” dhe të “pavarësimit” nga qyteti ekzistues. Kjo shfaqet në sjelljen e modeleve të reja që kanë të bëjnë me koncentrimin apo dekoncentrimin e popullsisë dhe të burimeve njerëzore në territor. Këtë “shqetësim” e mbartin pothuajse shumica e modeleve duke filluar që nga dy modelet e para, “qyteti linear spanjoll” (1882, A. S. Y Mata) dhe “qyteti

14 Frampton, Kenneth (1993), “Storia dell’Architettura Moderna”, (kapitulli: le trasformazioni territoriali: gli sviluppi urbani 1800-1909), fq.11-12, Zanichelli Editore s.p.a. Bologna, (terza edizione aggiornata).

kopsht” anglez (1898, Howard), e deri tek modelet e ditëve të sotme si ai policentrik evropian dhe rajonal Amerikan (seria e figurave 4). Kështu, Howard-i përmes teorisë së “qyteteve kopsht”¹⁵propagandonte një model të ri qyteti, i cili të gëzonte të mirat e dy vendbanimeve të njerëzimit të qytetit dhe të fshatit. Në një mënyrë tjetër edhe “Qyteti Industrial”¹⁶ i Tony Garnier i vitit 1904 (seria e figurave 5) shprehte një organizim të ri social-ekonomik me besimin se e ardhmja e qytetit do të ishte industria dhe nëpërmjet zonimit të qytetit me funksione të ndara paralajmëronte principet e “Kartës së Athinës” të CIAM-it që më vonë do të shpallehin si parime universale. Po ashtu “qytetet lineare të Bashkimit Sovietik”¹⁷të viteve ‘30 (seria e figurave 6) me strukturë barazitare të krijuar nga fasha paralele sipas funksioneve, që fillonin nga industria e përfundonin tek bujqësia, ofronin modelin e një qyteti bujqësoro-industrial që bazuar në ideologjinë komuniste të kohës do të bashkonte në të njëjtin vendbanim dy klasat “mike” fshatarësinë dhe klasën punëtore. Këto qytete synonin gjithashtu shpërndarjen e popullsisë sipas linjave të energjisë elektrike dhe të autostradave. Ndërsa modeli “antiurban” i Wright-it, “qyteti gjithandej dhe asgjëkund”¹⁸, synonte zhdukjen

15 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: le trasformazioni territoriali: gli sviluppi urbani 1800-1909) fq.20-21.

16 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: Tony Garnier e la “cité industrielle” 1899-1918), fq.108-113.

17 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: La nuova collettività: arte e architettura nell’Unione Sovietica 1918-1932), fq. 200-204.










18 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: Frank Lloyd Wright e la “Disappearing City” 1929-1963, fq. 216-217, 220-222.

graduale të dallimit midis qytetit dhe fshatit nëpërmjet shpërndarjes më uniforme të popullsisë (seria e figurave 7). Më 1928 Wright-i krijoi termin “Usonia”, i cili përcaktonte një kulturë barazie dhe një formë të re civilizimi të shpërhapur që bëhej e mundur nga përdorimi i automobilave. Projekti i tij për “Broadacre City” (1934) propozonte që koncentrimet urbane të shekullit të XIX-të të shpërndaheshin sipas një rrjeti agrar kënddrejtë të shkallës rajonale “i ndryshëm nga ai i së shkuarës dhe i së sotmes, i tillë që nuk do të jemi në gjendje ta përcaktojmë si qytet”. Wright-i vinte në pikëpyetje vetë nevojën e ekzistencës së qyteteve në formën që ato kishin duke shtruar pyetjen në se qyteti ishte një formë e përsëritur e sëmundjes shoqërore që herët ose vonë shfaqet në fatin e çdo qyteti. Disa dekada më vonë, Doxiadis-i besonte se “ekistiks”¹⁹- shkenca e vendbanimeve njerëzore e përbërë nga pesë elemente: njeriu, shoqëria, strehët (të gjitha llojet e ndërtimeve), rrjetat (transporti, komunikacioni, shërbimet, organizimi dhe struktura e tyre) dhe natyra (ekosistemi ku njeriu dhe shoqëria veprojnë) si edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre – do të zgjidhte në mënyrë të integruar problemet e vendbanimeve njerëzore. Modeli i tij i urbanizimit i shprehur tek “Ecumenopolis-i”, qyteti global dinamik i përbërë nga të gjitha llojet e qyteteve të lidhura që sot i quajmë “megalopolis”, do ta qarkonte gjithë globin si një sistem i vazhduar universal përmes “dinapolis”. “Dynapolis” (1950) nënkuptonte qytetin dinamik që rritej sipas konfiguracioneve lineare (seria e figurave 8). Në vitet ‘90

19 Lang Jurg, C. A. Doxiadis and the science of human settlements, tek *Time-saver Standards for Urban Design*, fq. 3.3-1 – 3.3-17, botues Watson Donald, Plattus Alan, Shibley Robert, Mc Graw-Hill, 2001.

dhe në fillim të mijëvjeçarit të ri Calthorpe P dhe Fulton W ²⁰shkruajnë mbi idenë e “Qytetit Rajonal” Amerikan të “lexuar” përmes katër blloqeve formuese: qendrat (lagje, fshatra si dhe qytete të mëdha apo të vogla), distriktet (zona me përdorim të caktuar), zonat në ruajtje të cilat mund të jenë hapësira apo habitate të rëndësishme dhe korridorët lidhës natyralë apo infrastrukturale. Struktura rajonale e rritjes në këtë qytet drejtohet nga shtrirja e tranzitit dhe veçoritë specifike natyrore të rajonit. Ky qytet nënkupton gjithashtu krijimin e lagjeve mbi bazën e përzjerjes së funksioneve dhe konceptit të rezerve të “ecshmërisë”, si edhe një dizajn urban, i cili krijon hapësira publike dhe arkitekturë në shkallë njerëzore (seria e figurave 9). Ky model së bashku me modelet e rrjetave policentrike europiane mund të konsiderohen si mundësi të reja të shprehjes së urbanitetit në një shkallë dhe dimension krejtësisht të ri të rrjetave teknologjike dhe të infrastrukturave. Edhe në këtë rast synohet të zbuten efektet negative të superkoncentrimeve dhe diferencat qendër-periferi, si edhe të mundësojë konkurrencën e qyteteve më të vogla me mega-aglomeratet mbi parimin e plotësueshmërisë.

Modelet e reja janë rrjedhojë e mjeteve të komunikimit, transportit dhe teknikës në përmirësim. Kështu, transporti mbi shina i dha hov modeleve radiale, lineare, satelitare të përmendura me sipër. Le Corbusier, tek “La ville Radieuse” vitit 1931 (Seria e figurave 10) shprehu idetë lidhur me civilizimin e kohës së makinave; Wright-i ndërtoi modelin “Broadacre City” të bazuar në prodhimin e makinave Ford.
20 Calthorpe Peter, “The Regional City”, tek *Time-saver Standards for Urban Design*, fq. 1.5-1 – 1.5-8, botues Watson Donald, Plattus Alan, Shibley Robert, Mc Graw-Hill, 2001.



Seria e figurave 4

Skema të "qytetit linear spanjoll" (1882, A. S. Y Mata)
 Skema të "qytetit kopësht" anglez (1898, Howard)
 Modeli policentrik evropian (nga rrjeti ESPON) dhe rajonal amerikan i ditëve të sotme

- 4.1 - 4.5 Skemë e "qytetit linear" spanjoll
- 4.6 - 4.8 Skemë e "qytetit kopësht" anglez
- 4.9 Imazhe nga Erich Fisher (Europe)
- 4.10 European spatial development perspective (ESPON)
- 4.11 - 4.13 "Banania" Europiane
- 4.14 Polycentric development in Flanders
- 4.15 Metropolitan Territory of the POLYCE Capital Cities
- 4.16 Imazhe nga Erich Fisher (USA)

Seria e figurave 5


"Qyteti Industrial" Tony Garnier i vitit 1904

Seria e figurave 6

"Qytetet lineare të Bashkimit Sovietik" të viteve '30

Seria e figurave 7


Modeli "Antiurban" i Wright-it, "qyteti gjithandej dhe asgjekund", "Broadacre City" (1934)



5.1




5.2



5.3




6.1



6.2





6.3



6.4



6.5



7.1



7.2



7.3

5.1-5.3 "Qyteti Industrial" Tony Garnier

6.1 Propozim për Magnitogorskun nga Ernest May 1930

6.2 Skema e qytetit linear

6.3 Propozim për Magnitogorskun nga Ernest May dhe bashkëpunëtorët

6.4 Propozim për Magnitogorskun nga Ivan Leonidov, 1930

6.5 Moisei Ginzburg dhe Mikhail Barshch, skemë dizurbanizmi për një qytet linear, 1930

7.1 "Broadacre City", Frank Lloyd Wright, 1934


7.2 "The living city", Frank Lloyd Wright, 1958

7.3 Frank Lloyd Wright


7.4 "Broadacre City", Frank Lloyd Wright, 1934

7.5 "Broadacre City"


7.6 "Broadacre City", detaj i planit





7.4



7.5



7.6



Seria e figurave 8

"Dyropolis", qyteti dinamik që rritet sipas konfiguracioneve lineare, Doxiadis 1950

Seria e figurave 9

"Qyteti Rajonal" Amerikan i "lexuar" përmes katër billoqeve formuese, Galthorpe P dhe Fulton W, 2000

Seria e figurave 10

Le Corbusier, "La ville contemporaine", 1922", "La ville Radieuse", 1931

Seria e figurave 11

Teknologjitë e mbijetesës, Archigram, Metabolist, etj.

8.1 Skemat teorike të "Dyropolis", Doxiadis

8.2 Qyteti global (ecumenopolis), Doxiadis

8.3 Master-plani original i Islamabad-it, Doxiadis, 1960

9.1 Metropolitan Portland, Oregon, centers, districts and corridors

9.2 Skema të shpërndarjes së TODave (transit oriented development)

9.3 TOD-të dhe raporti me tranzitin dhe qarkullimin

10.1 "La ville Radieuse", Le Corbusier, 1931

10.2 "La ville Radieuse", Le Corbusier, 1931

10.3-10.5 Perspektiva mbi avenutë e qytetit "la ville contemporaine"

11.1 Plug-in city, Peter Cook 1964

11.2 Walking city, Herron 1964

11.3 Marin city, Kikutake 1958

11.4 Struktura hapësinore për qendrën në Hagi, Kikutake 1968














Fig. 6. Relationship to transit and circulation. The site must be located on an existing or planned trunk transit line or on a feeder bus route within 10 minutes travel travel time from a stop on the trunk line. Where transit may not occur for a



11.5 Qyteti elikoidal, Kurokawa

11.6 Kulla Nagakin, Kurokawa, 1971

11.7 "Plug-in City", P Cook, W. Chalk, R. Herron, D. Crompton, M. Web 1964

11.8 Qyteti hapësinor, Izosaki 1962

11.9 Babelonah, projekt për 6 milion banorë, Paolo Soleri 1971

11.10 Plani për Tokion, Tange, Kurokawa, Izosaki, 1960

11.11 Agricultural city, Kurokawa 1960

11.12-11.13 Liliypad, Floating Ecopolis for Climate Change Refugees, Vincent Callebaut 2008

Qytetet Lienare të BS u zhvilluan përgjatë linjave të elektrifikimit dhe përmbanin edhe rrugët e transportit dhe hekurudhat. Vitet '50 shënuan një epokë të re të shpejtësive, të transportit automobilistik privat dhe të teknologjive të reja. Grupi Archigram solli imazhet e kësaj epoke të re në vitet '60. Po ashtu, në një aspekt më praktik dhe funksional, në ditët tona TOD-të (Transport Oriented Development) zhvillimi i orientuar nga tranziti në qytetin rajonal, janë të lindura dhe të orientuara nga sistemet e levizjes dhe kombinimi i tyre me zonat e banimit me përdorim të përzier përgjatë sistemit të tranzitit rajonal (seria e figurave 9).

TOD-të kanë strukturë nyjore të grupuar nga një stacion tranziti në distancë të "ecshme" nga zonat e banimit, qendër tregtare, shërbi



sikurse edhe "Qyteti Elikoidal" i Kurokawas ku "qelizat" e banimit vendosen të ngjiturra pas një "qiellgërvishtësi" elikoidal janë rezultat i presionit të mbipopullimit në vend. Po kështu Fuller, më 1968 sjell imazhet e një kupole gjeodetike mbi qendrën e Manhattan-it, si një "mushkëri urbane gjigante", si pjesë e teknologjisë së mbijetesës²². Rreziku i ngrohjes globale dhe kriza e energjisë që diskutohen shumë në ditët e sotme kanë nxitur "fantazi" urbane, siç është Lilypad nga Vincent Callebaut-it. Ky është një "qytet lundruar", që do të përballojë katastrofat për shkak të ngrohjes globale dhe që synon të ofrojë strehë për "refugjatët" e periudhës pas ndryshimeve klimatike²³. Ky qytet është tërësisht autosuficient dhe jo vetëm që nuk do të shkarkojë, asgjë por do të prodhojë energjinë e vet nga dielli, baticat, era apo

Y Mat-ës (1882), që do të siguronte prezencë urbane në të dyja anët e një rruge trafikuar me gjatësinë e një qyteti ekstremitetet e të cilit mund të ishin Cadiz-i dhe S.Pieterburg-u, Pekini apo Brukseli²⁴; Me një strukturë më komplekse edhe Qytetet Linere të BS-së në vitet '30 me funksione të vendosura sipas gjashtë fashave paralele mund të rriteshin në dy drejtime pa ngatërruar radhën e vendosjes së funksioneve në drejtimin pingul me aksin e tyre²⁵.

Po ashtu edhe "Dynapolis" i Doxiadisit mund të rritej në mënyrë dinamike përgjatë një aksi linear duke filluar nga qendra nëpërmjet shtimit të "qelizave statike" brenda rritjes dinamike të gjithë "organizmit"²⁶. "Qyteti kopsht" i Howard-it (1898) gjithashtu mund të mbulonte gjithë

Corbusier-i me "la ville radiuse" (1931), po ashtu kaloi nga modeli i qytetit "qendror" në atë që teorikisht mund të ishte pa kufinj, qytet i hapur, ku rregulli arrihej nëpërmjet strukturës së funksioneve që lejojnë rritjen e tyre me fasha paralele të bazuar në principin e Milyutin²⁸ (seria e figurave 4, 6, 8, 10). Në fakt edhe fashat e propozuara nga Grupi OMA, R. Koolhaas, E. Zenghelis (në vitet '80), të cilat janë sisteme lineare shumë komplekse me një spesor të caktuar, në mënyrë të ngjashme me sistemet e disurbanizmit të viteve '30, mbartnin potencialin e shtrirjes së pakufijshme²⁹. Ato zbulonin ekzistencën e një rregullsie territoriale specifike, si teksturën e tokave, rrethinat, infrastrukturën, etj. dhe njëkohësisht mundësonin "mbartjen" e elementeve të reja të kërkuar nga programi i projektit si hapësirat, shërbi

Seria e figurave 12
Fashat e propozuara nga OMA, për qytetin e ri të Melun-Senart, 1987.
Skemat me elementet e projektit dhe mbivendosja e fashave si sisteme lineare me një spesor të caktuar.



me publike të kombinuara me ato të punës dhe hapësirat publike.

Me arritjet e teknikës lidhet edhe një aspekt tjetër që sollën këto modele, siç domos ato pas viteve '50, kur njerëzimi kishte hyrë në një fazë të re të zhvillimit dhe të rreziqeve që sillte ky zhvillim. Kështu teknologjinë e mbijetesës e shohim tek "Qytetet e Lëvizshëm" nga Herron (1964) për të lëvizur solemnisht te nesërmen e shkatërrimit bërthamor²¹; "Qyteti mbi Ujë" i Kenzo Tanges dhe "Qyteti Marine" i Kikutakes (1958);

21 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: luogo, produzione e architettura: verso una teoria critica del costruire), fq. 332.

biomasa. Në këtë aspekt, këto modele më shumë se sa ide për zbatime konkrete janë pjesë e presionit për rritjen e ndjeshmërisë sociale dhe politike për balancën midis zhvillimit dhe ruajtjes së mjedisit (seria e figurave 11).

Modelet e reja mbartin gjithashtu tendencën për shtrirje dhe përdorim universal. Këtë potencial e mbartin modelet lineare që nga "qytetet lineare" i Arturo Soria

22 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: luogo, produzione e architettura: verso una teoria critica del costruire), fq. 332.

23 Vincent Callebaut (2008), "Lilypad, a floating ecopolis for climate refugees", <http://vincent.callebaut.org/page1-img-lilypad.html>.

hemisferën tokësore²⁷ (Boggiano A. 1992) me një rrjet "komunitetesh të dimensionuara", të grupuara këto në një qytet federativ me 250 mijë banorë që përbëhej nga 6 qytete me 32 000 banorë dhe një qytet kryesor në qendër me 58 000 banorë. Le

24 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: le trasformazioni territoriali: gli sviluppi urbani 1800-1909) fq.20-21.

25 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: La nuova collettività: arte e architettura nell'Unione Sovietica 1918-1932), fq. 202-204.

26 Lang Jurg, *vepra e cituar me sipër*, fq. 3.3-1 – 3.3-17

27 Boggiano Augusto (1992), "La centralità urbana, la progettazione di un luogo centrale urbano", fq. 23, Alinea, Firenze 1992.

met, poet intensive etj., duke u kthyer nga "zona" funksionale në "matrica funksionale". Këto sisteme lineare pajtonin "rregullin" ekzistues te formuar nga "shtresëzimet e gjurmëve" me vendosjen e një rregulli të ri territorial dhe social (Lucan J. 1991) (seria e figurave 12).

Synimi që kanë këto modele për të vendosur raporte të reja të popullsisë në territor shpreh gjithashtu tendencën për të mbajtur një madhësi të kontrolluar të

28 Frampton Kenneth (1993), *vepra e cituar me sipër*, (kapitulli: Le Corbusier e la "Ville Radieuse" 1928-1946), fq. 207-208.

29 Lucan Jacques, (1991), "OMA Rem Koolhaas", *Architetture 1970-1990*, fq. 13-16, Nga seria Documenti di Architettura. Electa Milano 199.



Qendra Ndërkombëtare e Biznesit, Lille 1989-1991




13.1




13.2

13.1 - 13.2 "Edeni" i banesave dhe oborreve në raport me ambientin e jashtëm



13.3

13.3 "Edeni" në shkallë territoriale: Pozicionimi qendror i Tiranës në Fushën e Tiranës.



13.4

13.4 "Kërthiza e një pellgu" në raport me malet dhe lumenjtë, "vendi i shenjtë" për të filluar ngulimi i qytetit

vendbanimeve brenda sistemeve universale. Kjo "dilemë" pasqyrohet edhe tek qyteti policentrik evropian, i cili shihet si një strategji për të balancuar zhvillimet hapësinore në shkallë të kontinentit evropian, brenda specifikave lokale. Edhe në ditët e sotme raportet midis rrjetit të vendbanimeve njerëzore dhe territorit mbeten një çështje për eksplorim.

Në konkluzion, kuptojmë rolin e "imagjinatës urbane" në shtytjen për të krijuar "vendin ideal". Kjo e "pozicionon" qytetin si një vepër të ndërtuar nga njeriu, por që qëndron "midis ëndrrës dhe realitetit"; midis spontaneitetit dhe dëshirës për rregull; midis gjendjes si jemi dhe si duam të jemi. Pikerisht kjo "dëshirë e papërbushur" midis realitetit dhe aspiratave është përpjekja "në kërkim" të "vendit ideal". Këtë tendencë drejt "qytetit ideal" njeriu është përpjekur ta mishërojë në rregulla, ligje e institucione, instrumente, projekte e plane, të cilat supozohet të garantojnë transformimin e përqëndrimeve urbane dhe të vetë shoqërisë. Në vazhdim le ta shohim këtë konkretisht në rastin e Tiranës.

TIRANA MIDIS ËNDRRËS DHE REALITETIT Nga fushat bujqësore drejt "aksit kozmik" ... nga unazat mbërthyesë drejt qytetit arkipelag.

Për Tiranën mund të shtrojmë pyetjet: a është zhvilluar Tirana "e pas zanafillës" në përputhje me ndonjë model të caktuar paraprirës? Produkt i cilave "arsye" është Tirana? Cilave forca transformuese? A është Tirana më shumë produkt i planeve apo produkt i spontaneitetit njerëzor; në ç' masë qëndrojnë këto? Për këtë do të duhet të studiojmë ra-

portet midis "qytetit në fluks" me tentativat për të vendosur rregull dhe kontrolluar formën përmes planeve e projekteve.

Midis spontaneitetit njerëzor dhe hyjnore të "vendit të shenjtë".

Si shumë qytete edhe Tirana mbart brenda vetes bashkëzistencën e spontaneitetit njerëzor dhe "hyjnore" të shprehur në "copëzat" e "qytetit / vendit ideal". Këtë të fundit mund ta gjejmë në forma dhe shkallë të ndryshme, që nga konceptimi i banesave dhe oborreve që përfaqësojnë një lloj "edeni" në raport me ambientin e jashtëm, e deri tek pozicionimi i Tiranës në Fushën e Tiranës: "kërthiza e një pellgu" që rrethohet nga male e kodra, "vendi i shenjtë" për të filluar ngulimi i qytetit (seria e figurave 13). Pozicionimi qendror në raport me kufizuesit natyrorë, raportet me malin dhe lumenjtë që ofrojnë mbrojtjen dhe burimet e rëndësishme për jetën, identifikimin dhe orientimin hapësinor; dhe që më pas do të drejtonin zhvillimet e mëtejshme, të kujton situatat e qyteteve ideale: qyteti si "qendra e territorit" dhe e " gjithë universit". Këto cilësi u vizualizuan me bërthamën e parë koncentrike të krijuar si pasojë e bashkimit të disa përqëndrimeve fillestare, të lindura në ndërthurjen e trajektoreve rajonale Durrës -Dibër dhe Elbasan - Krujë me përroin e Lanës. Pas kësaj fillese qyteti vazhdoi të rritej përreth bërthamës koncentrike. Tentativat e para të projekteve për të dalë jashtë kësaj bërthame i ngjasojnë utopive urbane, po të krahasohen me situatën e Tiranës së asaj kohe. (Fig. 14 sheshi qendror i ministrive me aksin në sfond). Për mënyrën

e agregimit të banesave që konceptonin edenin e mbyllur shiko serinë e figurave 3: "Lagja Dibrane" dhe e "Tiranës së Re".

Nga vetëm spontane në "urbanistike"

Për herë të parë forma organike e qytetit që po zhvillohej u impaktua nga projektet e fillimit të viteve '20 të shekullit të kaluar. Midis vitit 1923 dhe 1930 Tirana pati disa projekte dhe plane që shënuan fillimin e një "shtrese" të re në qytet dhe synuan të "drejtojnë" e "kontrollojnë" formën e saj. Qytetet shqiptare në atë periudhë, përfshi



edhe Tiranën kishin strukturë ekstensive dhe organike. Ndërhyrje dhe ide për ndërhyrje të kësaj periudhe në Tiranë kanë qenë drejtimi dhe zgjerimi i radiales së Rrugës së Durrësit e të Kavajës (seria e figurave 15), projekti për bulevardin dhe ideimi i sheshit qendror të Tiranës në jugperëndim të pazarit, sistemimi i lumit të Lanës (seria e figurave 16), rrjeti rrugor kuadratik i Tiranës së Re me zhvillim ekstensiv në formën e një "qyteti kopsht" me parcela 1000-1500 m etj (seria e figurave 3).

Ndërhyrja kozmike: "axis mundi" i Tiranës dhe qyteti që "solli qiellin"

Ndër të gjitha ndërhyrjet fillestare vlen të përmendet "aksi kozmik" i Brasinit. Nga akset radiale që përbejnë skeletin kryesor të Tiranës, aksi i bulevardit është i vetmi i projektuar dhe i ndërtuar nga e para, me efekte katalitike të "rithemelimit" të një qyteti ekzistues (seria e figurave 17). Ky aks tentoi të rakordojë "qytetin spontan" të fillesave me "qytetin e themeluar" në jug të të parit, por që ende nuk ishte zhvilluar. Për të sqaruar kuptimin metaforik të përdorimit të termit "kozmiq" në vazhdim jepem dy re-



Seria e figurave 14

"Qyteti ideal i Tiranës": sheshi qendror i ministrive me aksin në sfond.



ferenca teorike nga Kevin Lynch dhe Christian Norberg-Schulz. Kevin Lynch³⁰ në librin "Forma e mire e qytetit" (1981) që sipas Kostov (Kostov S. 2003) është një nga përputhjet më të mira midis studimit të historisë së formës urbane dhe teorisë së dizajnit urban, paraqet disa modele që kanë të bëjnë më shumë me motivin e ekzistencës së qyte-



Burimet fotografike historike:
Nga librat: Tirana në kartolina deri në vitin '44 (bazuar në koleksionet e kartolinave të A Lame, N Xharo, V Xhitomi), Toena 2000
Tirana, përgatitur nga S Jasa, B Zajmi me fotografi të: P Kumi, P Sula, N Kasapi, R Veseli, Xh Beluli, Shtëpia Botuese "8 Nentori", 1989.

Seria e figurave 17

"aksi kozmik" i Brasinit: qyteti që "solli qiellin"



17.3

tit se sa me rendin politik apo ekonomik. Sipas Lynch-it, Modeli Kozmik, ose "qyteti i shenjtë", është interpretimi në planimetri i universit ose i zotërve: akse monumentale, mbyllje dhe porta mbrojtëse, shenja dhe sinjale që dominojnë, zhvillimi sipas rrjetave të rregullta dhe organizimi hapësinor hierarkik. Ky model përfshin edhe qytetet ideale të Rilindjes dhe të Barokut të zhvilluara si një shprehje e fuqisë. Ndërsa, Ch. Norberg Shoulz në librin Genius Loci³¹ na ndihmon



17.1 Sheshi i ministrave, fillimi i aksit të Brasinit dhe raportet e tyre me "pazarin e vjetër" dhe qytetin, 1937

manifestimit të shpirtit lokal përmes arkitekturës, në se "arkitekturën" do ta kuptojmë si konkretizimin e vendeve artificialeMe "arkitekturë kozmike" Schoulz-i ka parasysh mjedise që transmetojnë vendosjen e një rregulli të përgjithshëm abstrakt, të karakterizuar nga rregulli absolut. Për sa kohë "tejkalon" një situatë konkrete, "hapësira kozmike" është rreptësisht gjeometrike dhe konkretizohet përgjithësisht përmes rrjetave të rregullta, ose kryqëzimit të akseve orto



17.2 Punë për ndërtimin e bulevardit, në sfond zyrat e komandës Italiane dhe kompleksi "dopo lavoro", 1939

në lexueshmerinë më të mirë të shpirtit lokal kur argumenton se si njeriu "ndërtoi" gjërat dhe si ai "rikrijoi" e përktheu në hapësire elementet e njohjes (Norberg-Schulz, Ch. 1992).

Nga mënyra se si njerëzit vizualizojnë, plotësojnë, simbolizojnë dhe grupojnë varet edhe "genius loci" i mjedisit të ndërtuar. Ai përdor disa kategori abstrakte, ndër të cilat edhe "peisazh kozmik" dhe "arkitekturë kozmike" për të shprehur një tendence të

gonale (cardo-decumanus), është uniforme dhe izotope, mund të duket dhe racionale dhe "abstrakte". Këto abstraksione kanë të bëjnë me faktorë njerëzorë të rëndësishëm që influencojnë në strukturën e vendit dhe raportet e tij me mjedisin natyral.

Në këtë kuptim aksi fillestar i Brasinit mund të konsiderohet si leximi dhe interpretimi abstrakt në shkallë gjeografike i "vendit të shenjtë": "kërthizës" natyrale ku u ndërtua më pas Tirana. Kështu ky aks, i cili në fillimet e tij krijonte raporte vetëm me shkallën territoriale (akoma jo me nje qytet që mungonte), lexoi "paralelin e ekzi-

stencës" që ishte Mali i Dajtit, një lloj "axis mundi"³²për fushën e Tiranës. Ai vizualizoi drejtimin dhe raportet që vendi kishte me malin, si edhe shtrirjen e "pafund" të fushës, së lexuar nga disa lumenj drejt detit. Kjo i jepte atij karakteristikat e një linje që shkante drejt "pafundësisë" (seria e figurave 17). "Bulevardi pa qytet" i ngjasonte një "aeroporti" absurd pasi në mungesë të referencave anësore dialogonte vetëm me qiellin. Edhe pse në fillesat e tij ai ishte jashtë shkal

edhe e vlerave eksistenciale. Kjo thekson edhe më shumë tipologjinë "kozmiqe" të tij në se i referohemi K. Lynch-it.

Projekti i kompleksit ceremonial qendror, "stacion" përgjatë këtij itinerari, reflektonte gjithashtu "tipologjinë hyjnore" në Tiranë. Pamja kryesore e fasadave të kompleksit të ministrave në raport me peisazhin dhe me aksin qendror ngjasonte me një utopi të realizuar në "fushën e Tiranës".

31 Norberg-Schulz, Christian (1992) "Genius Loci", Paessaggio ambiente, architettura; fq. 6-22, 42-45, 69-76, Nga seria Documenti di Architettura. Electa Milano 1992.

32 Termi është përdorur në mënyrë të ngjashme nga Norberg-Schulz, Christian (1992), vepra e cituar më sipër; fq. 6-22, 23-76, 189-202, (Electa, Milano).



17.4



17.5

The juxtaposition of the two cities

17.5 Influenca e aksit të bulevardit në "pëlhurat e reja" të Tiranës

Vizioni i planit të '42 dhe "tensionin e parë i bashkëstrukturimit"

Disa vite më vonë, plani "vizion" i hartuar nga Italianët G. Bossio dhe F. Poggi në vitin 1942, "lexoi" qartësisht skemën koncentrike dhe radiale të Tiranës dhe e bëri të dukshme atë, duke propozuar "rregullimin" e qytetit përmes një skeme që kombinonte

e shërbimeve, zona e panairëve pranë aeroportit (të vjetër), si edhe vendbanime satelitore siç ishte "qyteti kopsht" në kodrat e Paskuqanit pranë Lumit të Tiranës. Stacioni i trenit propozohej në jugperëndim të qytetit për garantuar më mirë lidhjen me Durrësin, Elbasanin dhe pjesën lindore të vendit, pozicionim ky që nuk u ndoq nga planet pasardhëse. Ky plan parashikonte në mënyrë


Nga pikëpamja morfologjike, ky plan synonte të lidhte të gjithë agregatin urban përmes një pëlhure të paramenduara, e cila shtrihej si mbi zonat e reja të qytetit, ashtu edhe mbi strukturat e qytetit organik (seria e figurave 19). Kjo morfologji në shkallë qyteti synohej të arrihej përmes kombinimit të kësaj pëlhure me tipologji specifike të ndërtimit, të cilat ishin të reja për qytetin e Tiranës. Në këtë aspekt ky plan ritheksoi disa elemente të propozuara edhe nga planet e mëparshme dhe synoi të kombinonjë vetërregullimet historike me strukturimet urbanistike. Si i tillë krijoi për herë të parë "tensionet e bashkëstrukturimit" në shkallë qyteti. Pjesë e këtyre kontrasteve të reja janë zonat rezidenciale të "Tiranës së re", në idenë e një "qyteti kopsht" të thurur me rrjet kuadratik dhe të përmesuar nga aksi i bulevardit. "Të huaja" dhe të panjohura për qytetin e Tiranës, këto njësi paralelizojnë pëlhurat organike të origjinës dhe qëndronin në kontrast të thellë me to. Ky rrjet sipas të cilit u rikonceptuan këto entitete të reja, ishte rrjedhojë e influencës që vinte në pëlhurën e gjithë qytetit nga bulevardi: "aksi kozmik" dhe leximi i kujdesshëm i tendencave të situatës ekzistuese. Ky ishte një hap i rëndësishëm për rritjen e pasurisë morfologjike të Tiranës dhe krijoi "energji" të brendshme pozitive për transformime të mëtejshme. Edhe pse të transformuara në raport me idenë e tyre fillestare, këto entitete janë ende sot të "lexueshme" si pjesë e rëndësishme e Tiranës (seria e figurave 20). Me rritjen e qytetit këto njësi iu nënshtruan "mbivendosjeve" të vazhdueshme dhe në disa raste, si p.sh., zona e "Bllokut", edhe ndryshimeve rrënjësore të tipologjive arkitektonike, mbi bazën e të cilave ato ishin të

konceptuara. Këto lloje tensionesh vendosin në presion zona të gjera të qytetit me pasojë tjetërsime të mëtejshme.

Aksi i Brasinit përbënte pothuajse boshtin e simetrisë së planit të vitit 1942. Edhe në këtë plan, ai duket se mishëron karakterin se si lindi dhe u "rithemelua" vetë qyteti i Tiranës; historinë që lidh origjinën e qytetit me jetën në zhvillim dhe atë që prietet të vijë më tej; "rregullimin" e hapur drejt së ardhmes. Ky plan i atribuonte këtij aksi përveç cilësive "kozmiqe" për të cilat folëm më sipër, edhe disa cilësi të tjera, si "rakorduesin" midis qytetit organik spontan të themelimit dhe "Tiranës së Re" që po lindte; "grupuesin" e objekteve dhe të njësisve të reja urbane që për "gravitetin" i referoheshin këtij aksi (seria e figurave 19). Përmes propozimeve të këtij plani aksi i bulevardit tashmë nuk dialogonte vetëm me qiellin, por bënte të lexueshme një shkallë hierarkie të qartë zbritëse të rrjetave urbane nga aksi në drejtimet lindore dhe perëndimore. Këtotribute i dhanë atij me kalimin e kohës cilësinë e të qenit "bulevard" dhe më tej cilësinë e një "fashe"³⁴ komplekse që "sillet" si një "matriks" gjenerator, që grupon dhe mbivendos një larmi programesh, aktiviteteve dhe strukturash morfologjike. Kjo e tejkalon faktin e të qenit thjesht një bulevard. Këtë rol vazhdon ta luajë suksesshëm edhe në ditët e sotme, me potencialin e zgjatimit në drejtimin verior dhe rolin e njëjtë që prietet të luajë për ristrukturimin, "rakordimin" dhe "grupimin" e zhvillimeve kaotike në zonat ku do të shtrijë influencën e tij.

³⁴ Termi "fashe" dhe mënyra e përdorur në këtë artikull i dedikohet konceptit të grupit OMA. Tek Lucan Jacques, (1991), Libri "OMA Rem Koolhaas", Architetture 1970-1990, fq. 13-16, Nga seria Documenti di Architettura. Electa Milano 1991.

Seria e figurave 18
 Planet rregulluese të hartuara për Tiranën



radialet me tri nivele unazash sikurse edhe disa unaza të pjesshme të cilat theksonin si qendrën historike, ashtu edhe aksin monumental (seria e figurave 18).

Ky plan, i cili është nga më vendimtarët për historinë e formës së Tiranës, "fiksoi" qytetin në formën të cilën e kemi trashëguar edhe sot. Ai "rithemeloi" qytetin, duke ideuar ndër të tjera një strukturë të ndarë në zona të banimit, industrisë, pushimit e sporteve, stacionit hekurudhor

optimiste që pas 60 viteve qyteti do të arrinte një popullsi prej 130 000 banorësh³³(Aliaj B. 2003) gjë kjo që për Tiranën e asaj kohe dukej gati e pamundur, por ritmet e Tiranës dëshmuuan se "utopia" e asaj kohe u tejkalua shumë më përpara parashikimit. Dendësia mesatare sipas këtij plani do të ishte 130 banorë / ha. që nënkuptonte një zhvillim ekstensiv.

³³ 33 Aliaj Besnik, Lulo Keida, Myftiu Genc, "Tirana -Sfida e zhvillimit urban", fq 45, GVG 2003.

- 18.1 Plani rregullues i vitit 1942
- 18.2 Plani rregullues i vitit 1942
- 18.3 Plani rregullues i vitit 1957
- 18.4 Plani rregullues i vitit 1989
- 18.5 Skemë tentativë për planin rregullues, viti 2006
- 18.6 Skemë tentativë për planin rregullues, viti 2006


Plani i vitit 1942 krijoi bazën e referencës për planet që do të pasonin për Tiranën, edhe pse kjo nuk u pranua zyrtarisht. Deri në ndryshim të mijëvjeçarit të ri, pavarësisht ndryshimit të regjimeve dhe modelit ekonomik, vizionet planifikuese për Tiranën nga pikëpamja e drejtimit të formës së përgjithshme të qytetit, janë dominuar në vija të përgjithshme nga modeli që ofroi plani Bossio i vitit 1942. Këtu përfshihet edhe plani i fundit i periudhës komuniste, ai i vitit 1989, si edhe disa nga tentativat e pas viteve '90. Në fakt 50 vitet e sistemit të projektimit të centralizuar nuk sollën ndonjë risi konceptuale në zhvillimin e qytetit, përveçse shtuan ose modifikuan unazat, në të cilat Tirana “shtrëngohej” (seria e figurave 18). Kjo vinte si për shkak të kufizimeve ideore dhe ekonomike të kohës, ashtu edhe për shkak mungesës së edukimit të trashëguar në këtë fushë.

Periudha socialiste: “lagjes sonë i ka rënë plani”

Gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore deri në rënien e regjimit komunist Tirana pati edhe dy plane të tjera të përgjithshme rregulluese: të vitit 1957 dhe 1989 (seria e figurave 18). Gjatë kësaj periudhe urbanizimi ishte një instrument i demonstrimit të fuqisë dhe kontrollit të shtetit socialist. “Zonimi funksional” i bazuar në planet rregulluese ishte kriteri rregullues teknik kryesor, i cili vendoste destinacionet e përdorimit të tokës dhe kushtëzimet urbanistike përmes një serie treguesish të dendësive të banimit dhe të intensiteteve të ndërtimit, që bazoheshin në normativa fikse për banorë dhe në banesa tipe. Edhe pse në aspektin formal të përgjithshëm këto plane ngjasojnë me atë të vitit 1942 (në konceptin e skemave të qar kullimit radial unazor si edhe të respekti-

Seria e figurave 19

Plani rregullues i vitit 1942 (nga lart poshtë, gjendja ekzistuese e qytetit dhe skemat e planit)



Seria e figurave 20

“Qytetet brenda qytetit” dhe pasuria morfologjike e Tiranës. Tirana si “arkipelag”; nga studimi “Tirana metropolis research report”, Instituti Berlage 2004 (projekti nga Lu Zhang)





21.1 Kombinati i tekstileve "Stalin"



21.2 Qendra e informatikes



21.3

Lagja e re e banimit në mugën e "Barrkadave"



21.4

Pamje ajrore e Tiranës para viteve '90

Seria e figurave 21

Pjesë të qytetit të realizuara gjatë periudhës së "ndërtimit të socializmit"

mit të disa zonave funksionale), ndryshimet janë thelbësore përsa i takon mënyrës së transformimit të aspekteve të morfologjisë së brendshme historike të qytetit dhe përdorimit të tipologjive të reja, të cilat ishin kryesisht banesa tip të normuara. Mjafton të përmendim këtu se synimi i planit të vitit 1957 ishte të arrinte dendësinë 350³⁵ banorë / ha (Aliaj B. 2003) nga 130 që ishte ajo e propozuar nga plani i vitit 1942. Kjo metodologji e "re", përveç se tregonte probleme profesionale të mosnjohjes së subjektit urban, pasqyronte ngarkesën ideologjike të kohës, që synonte të "hapte vend" për qytetin, i cili do të garantonte shkëputjen nga e kaluara dhe do të nënshtronte historinë e

cialë ishte me pasoja shumë të rënda për të ardhmen e qytetit. Mjaftonte një "njollë" e ngjyrosur në planin rregullues për të "zhdukur" lagje të tëra. Këtej e ka origjinën shprehja: "Lagjes sonë i ka rënë plani". Përmes instrumentit plan po zëvendësohej doradorës qyteti organik-spontan i origjinës. Projektet e kësaj periudhe në Tiranë, me disa përjashtime, edhe pse sollën një model të ri urban të jetesës kolektive, mund të konsiderohen si "aliene" në raportet që krijuan me qytetin ekzistues, me elementet territoriale, ambientin njerëzor brenda tyre, gjë që u theksua me kalimin e kohës. Moskurimi i lidhjeve midis qytetit ekzistues dhe ndërhyrjeve të reja shkaktoi tensionet



Pamje e "Qytetit Studenti" përpara viteve '90



21.6 Pamje ajrore e Tiranës para viteve '90 (kryqëzimi i "21 dhjetorit" dhe blloku "Partizani")



21.7 Pamje e "Qytetit Studenti" dhe e qytetit në vitin 2010

qytetit ndaj një epoke të re. Për këtë u përdor në masë strategjia e "rizhvillimit" të lagjeve tradicionale. "Antikorpet" e lagjeve të reja të cilat konsideroheshin si krenaria e kohës si për nga përmasat, ashtu edhe për nga përdorimi i tipologjive të banimit kolektiv me apartamente 4-5 katëshe, po sillnin qytetin e "njeriut të ri". Këto "blloqe" do të zëvendësonin rrjetin hapësinor të banesave të ulëta me oborre, që mbartë rrezikun për një jetë individualiste jo të pëlqyeshme për rregjimin e asaj kohe. Të ndihmuara nga shtetëzimi i pronës private, impakti i këtyre ndërhyrjeve në strukturën urbane dhe so-

midis pëlhurave të tipologjive të ndryshme, "çarjet" dhe "plasaritjet", plagë të cilat u theksuan pas viteve '90; të lexueshme përmes inkoherencës së theksuar pamore, mungesës së identitetit dhe të një qyteti ende të pakonsoliduar. Këto lloj problemesh janë trajtuar në artikullin e A+P 5 dhe A+P 8³⁶.

Pavarësisht kësaj, disa ndërhyrje të kësaj periudhe dallojnë si për nga niveli i di-

36 Dharmo Sotir, A+P 5, Artikulli "Qyteti tërësia që përmban dialektikën e vetëkrijimit, midis morfologjisë së kaosit dhe të rregullit", fq. 9-33 shtator 2010; dhe A+P 8, Artikulli "Ndërtimi përmes shkatërrimit dhe shkatërrimi përmes ndërtimit: ndërhyrjet "antiqytet", kontekstualizmi urban dhe transformimi evolutiv i kontekstit", fq. 9-35, shtator 2011, Botues: Aliaj B. Dharmo S. Shutina D.

35 Aliaj Besnik, Lulo Keida, Myftiu Genc, vepra e cituar me sipër, fq. 58.




Në planet e reja rregulluese të qyteteve tona po luten kri- tere të reja urbanistike, si p.sh. ndarja e teritorit të banimit në lagje të mëdha, etj., për të arritur një zgjidhje më harmonike ndërmjet tre faktorëve bazë: punë, banim, pushim. Në foto maketi i lagjes Nr. 1-2 Tiranë.

Diçiturë e kohës nga revista "Shkenca dhe Jeta", 1974, nr.3

Seria e figurave 22

Projekte të shkallës urbane në Shqipëri krahasuar me ato në vende ish-socialiste (Rumani).

22.1 | Studimi pjesor i qendrës së Tiranës, 1974



22.2 | Pamje ajrore e qendrës së Tiranës (2001) dhe realizimet e planit të vitit 1974

zajnit ashtu edhe i relaizimit. Një nga shembujt më të arritur në urbanistikën e lagjeve të reja të banimit në Tiranën e kësaj periudhe është konsideruar “Blloku Partizani” i cili ofroi standarde të reja banimi, kjo edhe për faktin se arriti të pajisej me elementet e

gjelbërimit dhe të shërbimit që zakonisht nuk përfundoheshin asnjëherë. Edhe trajtimi estetik i fasadave të jashtme të kësaj lagjeje me tulla silikatë dhe me fugatura ishte mjaft i kujdesur dhe i veçantë për kohën. (seria e figurave 21: “Blloku Partizani” dhe maket i një lagjeje të re në Tiranë)

Me impakt të fortë për ndryshimet në qendrën e Tiranës ishte edhe ndërhyrja e bazuar në studimin pjesor të vitit 1974 (seria e figurave 22). Mbi bazën e këtij plani u vendos ndërtimi i Muzeut Kombëtar, sikurse edhe i disa objekteve të tjera të rëndësishme në frontin perëndimor dhe verior të sheshit me lartësi të barabartë me atë të Hotel Tiranës dhe që do të krijonin siluetën e qendrës, por që nuk arritën të ndërtohen.

Ky plan propozonte edhe ngritjen e “Monumentit të Lirisë” që pas vdekjes së diktatorit u kthye në Monumentin “Enver Hoxha”. Këto operacione kërkonin hapjen e hapësirës së qendrës, shembjen e ish-bashkisë si edhe të një rrjeti urban që ndodhej pas kësaj ndërtese. Ky ishte vazhdimi i operacioneve të filluara që me ndërtimin e “Pallatit të Kulturës”.

Plani i përgjithshëm rregullues i hartuar dhe i miratuar në periudhën 1985-1989 dhe që përmbante parashikime deri në vitin 2005, ishte i fundit i hartuar gjatë regjimit komunist (seria e figurave 18). Miratimi i tij vetëm dy vjet përpara se të ndodhnin ndryshimet e thella politike bënte, që principet mbi të cilat ai ishte hartuar të ndryshonin krejtësisht nga principet mbi bazën e të cilave do të zbatoheshin: ekonomia e tregut, lëvizja e lirë e popullsisë dhe shteti tashmë jo si i vetmi aktor. Ky plan parashikonte që popullsia e Tiranës në vitin 2005 do të arrihte në 317 000 banorë. Në fakt popullsia e Tiranës arriti këtë shifër që në vitin 1992. Ndërsa dendësia mesatare për shkak të rritjes së sipërfaqes së banimit pësonte një ulje nga 224 banorë / ha në vitin 1988 në 170 banorë³⁷ / ha në vitin 2005 (Aliaj B.

37 Aliaj Besnik, Lulo Keida, Myftiu Genc, vepra e cituar me sipër, (fq. 64).

2003). Dendësia mestare e synuar për vitin 2005 është edhe më e ulët se dendësitë e propozuara në planin e vitit 1957 (350 ba/ha). Kjo i blatohet faktit që në objektivat e tij plani synonte të përmirësonte cilësinë e zonave të banimit pavarësisht që kjo nuk u arrit. Plani synonte edhe përmirësimin e skemës rrugore dhe për këtë propozonte idenë e unazës së madhe të Tiranës përveç asaj ekzistuese. Kjo unazë u realizua vetëm në segmentin perëndimor dhe aktualisht



22.3 | Kompleks turistik në Mamaia, Rumani

është në zbatim segmenti jug-perëndimor (nga Rruga e Kavajës tek Rruga e Elbasanit). Nga propozimet me interesante të planit ka qenë hyrja e re në Tiranë nga drejtimi verior i bulevardit, duke e shndërruar kështu aksin e bulevardit nga një segment me tiparet e një “sheshi linear” të stërgjatur me dy skajet fundore: sheshi “Nënë Tereza” dhe Stacioni i Trenit, në një trajektore të hapur nga drejtimi verior që do të lidhej me Aeroportin e Rinasit dhe me rrugën e Fushë-Krujës. Kjo ide mbeti e pareaizuar, por u rikonsiderua nga disa dokumente të tjera të rëndësishme si plani i zonës suburbane të Tiranës në vitin 1994, Plani Strategjik i “Tiranës së

Madhe” në vitin 2001, nga studimi i masterplanit të qendrës së Tiranës në vitin 2004 si edhe aktualisht nga vizionet e zhvillimit të bashkisë së Tiranës, të cilat ende janë për t’u parë.

Gjatë periudhës pas Luftës së Dytë botërore deri në ndryshimet politike të vitit 1991, bazuar në realizimet e pjesshme të planeve të viteve 1942, 1957 dhe 1989, Tirana përforcoi më shumë karakterin si qytet monocentrik me një strukturë radiale dhe kon-

centrike me disa nivele unazash. Nga këto unaza realizoi atë që është unaza e sotme e “vogël” e qytetit, me përjashtim të pjesës lindore që ende mungon; realizoi pjesërisht unazën e qendrës; dhe realizoi vetëm një segment të vogël të unazës së madhe (midis Rrugës së Durrësit dhe të Kavajës); përcaktoi zonat e banimit dhe garantoj krijimin e lagjeve të reja për të përballuar rritjen e popullsisë si rezultat i rritjes ekonomike dhe administrative të kryeqytetit; krijoi fizionominë e gjenerimit të qytetit mbi bazën e “bloqeve/lagjeve të banimit”³⁸të bazuara 38 Një bllok banimi gjenerohej përreth “kopsht-çerdhes”, një kompleks banimi që përbehej nga 2-3 blloqe gjenerohej përreth shkol-




22.4 | Ansambli “IMaj” Calea Grivitei, Bukuresht



22.5 | Pamje e pjesshme e një kompleksi banimi

22.6 | Pamje e pjesshme e një kompleksi banimi

22.7 | Kompleks banimi



në modelin kolektiv dhe tipologjinë e apartamenteve të banimit shumëfamiljare; këto lagje ishin me plan urbanistik të hapur dhe të bazuar në normativa standarde arkitektonike, urbanistike dhe të shërbimeve; përcaktoi zonat e punës me krijimin e qendrave të industrisë tekstile (Kombinati "Stalin"), mekanike ("Kombinati i Autotraktorëve"), të përpunimit ushqimor (Kombinati "Ali Kelmendi") dhe të depove e magazinave, kryesisht të vendosura në periferinë lindore, perëndimore dhe veriore; përcaktoi zonat e pushimit dhe të parkut periferik të "liqenit" në zonën jugore.

Kjo skemë monocentrike e Tiranës me radialet qytetformuese që po arrinin distanca të konsiderueshme nga qendra, nuk ishte më efiçente dhe gradualisht po e fuste qytetin në krizën e shtrëngimit, aq më tepër që nuk ishte e ndihmuar nga sisteme

fillim të viteve '90, Tirana ende nuk ishte vënë në sfdat që kalon një kryeqytet si p.sh., rritja e popullsisë dhe gjetja e alternativave të koncentrimit apo të dekoncentrimit të popullsisë, aplikimi i teknologjive të reja të transportit apo të infrastrukturave të tjera të shërbimit, elemente këto që ende pritet të sjellin kapërcimin cilësor dhe një gjendje të re urbane në Tiranë.


Specialistët e kësaj periudhe, të cilët shohin veprimet e tyre të djeshme në dritën e sotme, dëshmojnë se këto projekte dhe ndërhyrje reflektonin edhe parimet e "rrymës së modernizimit" të pashprehura zyrtarisht, por të reduktuara dhe të filtruara nga parimet ideologjike dhe të ekonomizimit ekstrem socialist. Utopia për të krijuar "qytetin e ri" bazuar në simbolin e "Feniksit"³⁹ (Rowe C, Koetter F. 1978), që reflektohet në tentativat e vazhdueshme

mbi kontekstin Shqiptar, si hapësira e lirë dhe objekte të vendosura në distanca të mëdha, objekti arkitektonik në kontakt sa më të vogël me tokën derisa të duket i "avulluar", qyteti i ri si "status tranzitor"⁴⁰ (Rowe C, Koetter F. 1978) midis natyrës dhe qytetit, i izoluar nga perdet e gjelbërimit, zonimi funksional i pastër, identiteti etj., natyrisht do të kërkonin një studim më të thelluar, por në çdo rast janë për t'u marrë me rezervë pasi janë zbehur nga një ekonomi e varfër dhe nga kufizimet ideologjike, të cilat detyronin izolimin e arkitektëve dhe urbanistëve nga rrymat teorike të kohës. Është e vështirë madje të bëhet një krahasim edhe me urbanistikën dhe arkitekturën e vendeve të tjera ish-socialiste, ku kishin studiuar një pjesë e specialistëve, të cilat shfaqin tipare më të qarta në raport me referencat ndaj rrymave të kohës, sidomos në vendet e

e zgjidhjeve në kuadrin e kompleksitetit perfekt të të dhënave dhe informacionit të centralizuar, ndërsa në realitet veprohet në "paqartësi" dhe "joperfeksion". Këto plane vendosnin theks në parashikime afatgjata, deri 20- vjeçare e në ndonjë rast edhe me shumë, duke rrezikuar të qenët jorealistic. Parashikimet të cilat ishin kryesisht të natyrës fizike dhe të ndërmarra shpesh në mungesë të ndërveprimit midis përfituesve dhe përdoruesve përmbledheshin në një hartë "blueprint". Ky lloj sistemi i planifikimit dhe projektimit, që ishte i lehtë për t'u realizuar në kushtet e ekonomisë së centralizuar, hyri menjëherë në krizë pas ndryshimeve politike të viteve '90. Megjithatë, kjo fazë ishte mjaft e rendësishme pasi hodhi bazat e planifikimit në Shqipëri.

Seria e figurave 23

Zhvillimi fizik i Tiranës nga viti 1937 deri me sot



transporti. Qyteti mbetet në fazën "primitive" përse i përket konceptimeve alternative lidhur me drejtimet e shtrirjes dhe të zhvillimit. Deri në fund të regjimit komunist, në

³⁹ lës 8-vjeçare, dhe një lagje banimi që përbëhej nga 2 komplekse gjenerohej përreth shkollës së mesme (shënimi autorit bazuar në rregulloren e urbanistikës).

për të shpëputur lidhjet me qytetin e së kaluarës, është elementi më i ngjashëm. Përse i takon influencës së disave nga parimeve të tjera teorike dhe praktike më të njohura të arkitekturës dhe urbanizmit të modernizimit

³⁹ Rowe Colin, Koetter Fred (1978), *vepra e cituar më sipër, kapitulli: crises of the object: predicament of texture, fq. 72.*

ish-Jugosllavisë (Seria e figurave nga arkitektura RPR).

Nga një këndvështrim tjetër, këto plane përfaqësonin "paradigmën tradicionale" të planifikimit, e cila supozon arritjen

⁴⁰ Rowe Colin, Koetter Fred (1978), *vepra e cituar më sipër, kapitulli: crises of the object: predicament of texture, fq. 51.*


Tirana e "pas mureve rrethuese".

Nga këndvështrimi planifikues periudhën e pas viteve '90 mund ta ndajmë në dy periudha kryesore: deri në fillim të mijëvjeçarit të ri dhe deri në ditët e sotme.

Tirana e vitit 1990 kishte një formë

Seria e figurave 26

Tentativat planifikuese për Tiranën në shkallë qyteti dhe rajoni midis viteve 1990 dhe 2009



elipsi të shtypur dhe një “kufi” relativisht të qartë në raport me territoret e lira jo urbane që e rrethonin. Ndërsa situata e Tiranës në prag të viteve 2000 ngjasonte me situatën historike kur qyteti tradicional kompakt shpertheu pertej mureve apo kufizimeve mesjetare dhe shperhapjet urbane në periferi filluan të ravijezonin “de facto” në terren rajonin metropolitan (seria e figurave 23). E megjithatë, tentativat planifikuese deri në fillim të viteve 2000 nuk u përputhën me një vizion më të gjerë të rajonit metropolitan dhe synonin në mënyrë “të fiksuar” që Tirana të plotësonte formën koncentrike, që kombinonte vetëm radialet dhe unazat, edhe pse tashmë tendencat e “shpërthimeve” pertej qendrës ishin të qarta. Radialet e Durrësit, të Kavajës dhe të Kamzës, mbartnin qartësisht potencialet e përforcimit të zhvillimeve lineare; dhe me rritjen e konsiderueshme të distancave qendër-periferi edhe të “satelitimeve” të qendrave urbane të


reja. Kjo ishte një fazë kur urbanistika dhe planifikimi shqiptar ende vazhdonin të operonin me inercinë e sistemit të mëparshëm. Evolucionin konceptual nga kjo pikëpamje e shënuar planet e fillimit të viteve 2000. Të tillë kanë qenë Plani Strategjik i Tiranës së Madhe (2001) (seria e figurave 24) dhe vizioni “Tirana Metropolis” (2004), të cilët ndryshonin nga paraardhësit e tyre si nga konceptet analitike, ashtu edhe nga përmbajtja e propozimeve. Këto plane/studime konsideronin formën urbane të rajonit metropolitan: të cilësuar si “Tirana e Madhe” ose “Durana”. Tashmë Tirana ishte në atë fazë të proceseve urbane që kërkonte identifikimin e “formës” më të përshtatshme për të aktivizuar mundësi të reja dhe “inteligjencat e fjetura”. Kjo periudhë përkon edhe me hartimin nga Co-PLAN-i, në shkallë vendi të planeve të qyteteve të Kamzës (2001), të Fierit (2007) dhe të Elbasanit (2007), si edhe të një vizioni në shkallë

Seria e figurave 27


Plani Strategjik i Tiranës së Madhe

kombëtare për reformimin e sistemit të planifikimit (2005) (seria e figurave 24). Këto plane sollën një frymë të re në praktikën planifikuese shqiptare jo vetëm për hartimin e tyre me proces pjesëmarrjeje institucionale dhe qytetare, por edhe për sjelljen e koncepteve të reja metodologjike në një periudhë transformimesh dhe paqartësish të vazhdueshme. Kjo metodologji që bazohej në “leximin” realist dhe me pozitivitet për të zbuluar “çelësin” e zgjidhjes në gjendjet urbane, qofshin ato edhe të degraduara, krijoi vizione frymëzuese dhe shpresë për përmirësimin e strukturës urbane në qytetet e përmendura më sipër. Në këtë kuptim këto plane kapërcyen zyrtarisht “handicap-in” që vinte si pasojë e qasjeve reduktive funksionaliste, trajtimit të qytetit vetëm si subjekt të dhënash statistikore dhe mungesës së analizave lidhur me proceset morfologjike dhe historike të kryera me ndjeshmërinë e duhur. Këto u ndoqën si shembull edhe në tentativat për hartimin e planeve të qyteteve të tjera, madje edhe në hartimin e rregulloreve të planifikimit bazuar mbi ligjin e ri të planifikimit hapësinor (2010). Miratimi i tri planeve të përmendura më sipër⁴¹, shënoi pranimin zyrtar edhe në Shqipëri të paradigmes së “planifikimit sipas hapave gradualë në rritje”, të “planifikimit me pjesëmarrje”, të qytetit të studiuar jo vetëm si shifra statistikore dhe si funksion, por edhe si formë dhe si arkitekturë e hapësirës, si mundësi në rritje për qytetarët (seria e figurave 25). Kjo metodologji planifikimi e iniciuar nga Co-PLAN-i ishte shumë ndryshe nga para-


41 Plani Strategjik i Zhvillimit Urban të Kamzës dhe Plani i Përgjithshëm Rregullues i Fierit kanë marrë miratimin e plotë; ndërsa Plani i Përgjithshëm Rregullues i Elbasanit ka marrë miratimin vetëm për detyrën e projektimit (shënim i autorit).



27.1 Skema e përdorimit të tokës për vitin 2017



27.2 Skema e transportit mbi shtrata



27.3 Skema e qarkullimit

digma tradicionale, për të cilën u fol më lart. Tentativat planifikuese për Tiranën në shkallë qyteti dhe rajoni midis viteve 1990 dhe 2009 tregohen në skemën e paraqitur⁴² (seria e figurave 26). Siç duket nga kjo skemë shumica e tyre nuk arritën miratimin dhe aq më pak zbatimin. Kjo situatë tregon gjendjen e institucioneve të planifikimit në nivel qendror dhe vendor, si edhe kulturën “antiplan” që dukej se ishte kthyer në “formulë” të investimeve abuzive.

Plani Strategjik i Tiranës së Madhe⁴³ i hartuar nga Projekti Manaxhimi i Tokës Urbane i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare me asistencën teknike të PADCO-s midis viteve 2000-2001, nuk është një plan rregullues tipik i periudhave të mëparshme, por një vizion strategjik që synon të koordinojë zhvillimin në rajonin e “Tiranës së Madhe”, i cili ndodhet në juridiksionin e 11 pushteteve vendore: Tiranë, Kamëz, Vorë, Paskuqan, Zallherr, Berxull, Kashar, Vaqar, Farke, Dajt, dhe Nikel. Ky plan parashikonte zhvillimin e këtij rajoni deri në vitin 2017 dhe ndryshe nga çdo plan i mëparshëm analizonte tregun e pasurive të paluajtshme, vendbanimet informale, përcaktonte kostot dhe mënyrën sesi do të paguheshin propozimet e tij, sikurse

42 *Aliaj Besnik, Dharmo Sotir, Shutina Dritan, “Midis vakumit dhe energjisë”, fq 42-43. Skema origjinale është hartuar nga Driscoll John, Harvard Center for Urban Development Studies; dhe më tej është ri-interpretuar nga autorët e librit. Botues Co-PLAN, Dhjetor 2009*

43 *Materiali është përmbledhur nga artikulli i Dr. Yarwood John R.: “Implementing plans in weakly administered states: the case of Greater Tirana Strategic Plan”, paraqitur në konferencën ndërkombëtare të ENHR Tiranë, Botuar në librin “Making Cities Work”, fq. 121-139, seria e botimeve të Co-PLAN-it, Shtator 2004, dhe të librit “Tirana- sfida e zhvillimit urban”, fq. 105-109, Aliaj Besnik, Lulo Keida, Myftiu Genc, Tirane 2003.*

edhe ndryshimet ligjore që lehtësonin dhe mundësonin realizimin e operacioneve kryesore.

Ky plan propozonte për herë të parë idenë e largimit nga unazat bashkëqendrore në rritje, të cilat detyronin një skemë lëvizjeje sipas së cilës të gjitha drejtimet gravitonin në qendrën historike dhe “gjeometrike” (seria e figurave 27). Për këtë arsye, skema e transportit kombinonte tri nivelet e unazave, të cilat në koncept ishin të ngjashme me ato që parashikoheshin edhe nga planet e mëparshme (me ngjyrë blu në figurë) me dy “orbitalët” dhe dy “tangencialët”, të cilët synonin spostimin e trafikut të panevojshëm nga qendra. Orbitali i madh dhe orbitali i brendshëm janë “unaza”, por qendërsia e tyre është e zhvendosur në raport me unazat e mëparshme (me ngjyrë të kuqe në figurë). Qendra e tyre nuk ishte më sheshi Skenderbej, por ajo kishte filluar të “rreshqiste” në drejtim të perëndimit. Orbitali i madh i Tiranës shërbente të gjitha zonat e krijuara pas vitit '90, përfshi Kamzën dhe Bathoren dhe supozohej të evitonte futjen e trafikut në qendër pasi do të ndërpritej në një distancë të konsiderueshme nga qendra me trajektoret qytetformuese: Rrugën e Durrësit, të Shkodrës dhe të Kavajës. Të njëjtin synim kishin edhe dy tangencialet (treguar me jeshil): e para nga Babrruja deri në Rrugën e Elbasanit duke përmirësuar Alliasin, Rr. Bardhyl, Bërrylin, Rr. Ali Demi dhe Farkën; dhe e dyta, nga Rruga e Zall Herrit në veri deri në Kombinat e cila pasi ndërpriste Rrugën e Kamzës (Shkodrës) dhe atë të Durrësit, që kalonte nga Yzberishti. Niveli i rrugëve lokale garanton penetrimin nga unazat në drejtim të zonave të banuara. Për herë të parë ky plan propozoi përmirësimin e “Tiranës së Madhe” nga dy akse të


Seria e figurave 28

**“Tirana metropolis”,
Instituti Berlage 2004**


transportit mbi shina që fillonin njëra nga sheshi “Nënë Tereza” dhe tjetra nga Sheshi i “Kombinatit”. Pasi të dyja këto linja kryqëzoheshin në Bërxull, përfundonin në Aeroportin e Rinasit (seria e figurave 27).

Ky plan propozonte kompaktësimin e qytetit të kombinuar me një vizion policentrik ku përveç Tiranës ravigëzoheshin disa polaritete në shkallë territoriale, si Kamza, Bërxulli, Paskuqani, Kombinati etj. sikurse edhe pole të zhvillimit ekonomik dhe të shërbimeve përfshi këtu edhe aeroportin e Rinasit dhe Vorën. Kompaktësimi dhe ruajtja e një niveli të caktuar të dendësisë së banorëve lidhej edhe me financimin dhe operimin e sistemit të transportit, i cili nuk do të mund të realizohej poshtë një niveli të caktuar dendësie, përndryshe kostot do të ishin të papërbalueshme. Për këtë arsye, plani propozonte se nuk do të duheshin zona të reja banimi përpara 10 viteve dhe përcaktonte kufij të urbanizimit nëpërmjet “brezave të gjelbër”, sikurse edhe zona të rezervimit të tokës që nënkuptonte ndalimin e zhvillimit për interes publik.

Për herë të parë, plani propozonte edhe disa masa të karakterit manaxhial si p.sh., krijimin e autoriteteve metropolitane në mënyrë që disa nga shërbimet e Tiranës, përfshi atë të transportit publik, të ofroheshin në shkallë metropolitane që tejkalonte madhësinë e zonës administrative të bashkisë. Plani propozonte gjithashtu forma të reja organizimi, siç ishin “Korporatat e Zhvillimit Ekonomik” (KZHE) si forma të qeverisjes urbane, sipas të cilave, pushteti vendor delegonte dhe monitoronte plotësimin e interesave vendore, por nuk kryente vetë shërbimet. Ky plan propozonte katër zona ku mund të krijoheshin KZHE: “Nyjen e Bërxullit”, ku kryqëzoheshin orbitali i vogël



28.1 Strukturimi i Tiranës në formim, “albanian arcadia”, lindja e qendërsive të reja dhe të ndërlidhura (projekt nga J Declerck dhe M Ryan); nga “Tirana metropolis” research report, Instituti Berlage 2004



28.2 “Gërvishtjet dhe venat” në nivel urban; ndërprerje morfologjike që luajnë rolin e “Grupulluesve urbanë” (projekt nga B Bona, U Franzel, K Korsak dhe R Lomica); nga “Tirana metropolis” research report, Instituti Berlage 2004

me autostradën dhe linjat e transportit mbi shina; “Kombinatin” në ndërprerjen e orbitaleve me Rrugën e Kavajës; “Korridorin e Paskuqanit” si zonë investimi në vazhdim të aksit qendror të Tiranës dhe që kalonte mbi lumin e Tiranës; “Korridorin e Perëndimit”, i cili lidhte qendrën e qytetit, kalonte në nyjen e Bërxullit dhe vazhdonte përgjatë rrugës së Durrësit. Sikurse tregoi eksperiencia gjatë periudhës pas përfundimit të këtij plani, pushtetet vendore nuk ishin në gjendje të koordinonin këto zhvillime në mungesë të një marrëveshjeje të përbashkët.

Edhe përsa i takon strehimit social, plani nuk mjaftohej vetëm me përcaktimin e zonave në hartë, por rekomandonte tri forma sipas mundësive ekonomike të banorëve: së pari, ndërtime nga investitorët privatë dhe blerjen e banesave në tregun e lirë. Së dyti, përmirësimin e zonave me ndërtime informale si një ofertë strehimi me kosto të ulët. Kjo nënkuptonte kontributin e banorëve në pajisjen me infrastrukturë në proporcion me sipërfaqen e parcelës së banimit përmes një “fondi komunitar të mirëbesimit”. Kjo metodë kishte rezultuar e suksesshme në disa eksperiencia të provuara nga Co-PLAN-i dhe Projekti Manaxhimi i Tokës Urbane në Breglumas dhe Kamëz. Metoda e tretë kishte të bënte me banesa sociale të realizueshme në dy mënyra: subvencionim i drejtpërdrejtë nga sektori publik; dhe subvencionim i tërthortë, sipas të cilit bashkia mund të balanconte vlerën më të lartë të përfitimit nga lejet e ndërtimit në zona me interes të lartë, me kërkesën ndaj investitorëve për të ndërtuar banesa sociale ose për të pajisur toka me infrastrukturë, të cilat mund t’u jepeshin me qira shtresave më të varfëra nga ana e pushtetit vendor.

Kjo formë kërkonte bashkëpunimin publik dhe privat në dobi të interesave publike, kulturë kjo që ende nuk ekziston.

Ky plan tentonte t’i jepte përgjigje pyetjes: a mund të paguante shoqëria shqiptare zbatimin e këtij plani? Megjithëse pushtetet vendore theksonin vështirësitë e financimit të drejtpërdrejtë të projekteve, realizimet mund të ndodhnin vetëm në një sistem organizimi që mund të mobilizonte burimet brenda komuniteteve p.sh.: rritjen e vlerës së pronës përmes pajisjes me infrastrukturë dhe përmirësimeve katalitike. Kjo vlerë e shtuar që mund të mblidhej përmes taksës së pronës mund të përdorej për të ndërtuar një pjesë të infrastrukturës. Një pjesë tjetër mund të finançohej nga zhvilluesat private dhe banoret të cilët do ta bënin këtë për të rritur vlerat e pasurisë së tyre. Vlera tjetër (rreth 50%) mendohej të vinte nga financa publike (qeveria, pushteti lokal, ndihma/ kredi).

Plani Strategjik i Tiranës së Madhe deshmoi se Tirana nuk mund të manaxhohej më as me konceptet klasike të drejtimit të formës së qytetit as edhe me metodat klasike të qeverisjes urbane. Forma krijuese të financimit, të bazuara në bashkëpunimin publik dhe privat, të afta të tejkalojnë ngërçin financiar janë sfida, të cilat Tirana ende nuk i ka kapërcyer.

Tirana Metropolis-“qyteti arqipelag”


Një nga vizionet më interesante të dhjetëvjeçarit të fundit me cilësi paradigmaticke, që e konsideron Tiranën si një mundësi për të shprehur dhe eksperimentuar ide të reja, është ai i hartuar nga Instituti Berlage nën drejtimin e Elia Zengelis-it dhe Pier


Vittorio Aurel-it⁴⁴. Ky vizion përtej planifikimit të sheh Tiranën në këndvështrimin e një gjeografie metropolitane, ku migrimi i popullsisë kishte ndryshuar krejtësisht formën, ekonominë dhe aspektet sociale. Kjo situatë lexohet në idenë e “qytetit arqipelag” përmes disa ndërhyrjeve strategjike. Sipas autorëve, ky vizion propozon zhvillimin e strukturs urbane të Tiranës sipas një qasjeje “superkontekstuale” që bazohet në njohjen e thellë të kontekstit shqiptar dhe veçoritë specifike të tij, ku në vend të “tabula rasës” propozohet “riformatimi” i vlerave ekzistuese. Në këtë ide “arqipelagu” nënkupton plotësueshmërinë si një logjikë të brendshme përkundrejt anarkisë së entiteteve të veçanta dhe përfaqëson formën, e cila mbart efektet katalitike që nxisin jetën dhe vetëdijen e publikut, duke mundësuar kështu qëndrueshmërinë afatgjatë të metropolit.

Mbi këto principe vizioni propozon një strategji dizajni të përmbledhur në pesë veprime (seria e figurave 28), të cilat mund të nxisin procese transformuese në të gjithë qytetin: “Fine dhe Tuning” nënkuptonte “distilimin” e pëlhurës urbane me qëllim zbulimin e kualiteteve të “fjetura” në zonat urbane, përfshirë edhe ato me kualitet të dobët në kundërshtim me idetë për eliminimin e tyre. Mbi këtë bazë mund të bëhej “përforsimi i strukturës së pëlhurës”. Për këtë mund të përdorej edhe rimobilimi i rrugëve dhe ndriçimi i natës që mund të transformonin eksperiencat urbane. “Strukturimi i Tiranës

⁴⁴ “Tirana Metropolis”, fq. 18-23, *The Berlage Institute Research Report, 2004. Ky libër paraqet raportin e studios kërkimore “Tirana: a modern European capital: a studio by Elia Zenghelis and Pier Vittorio Aureli, Editors Joachim Declerck, Bart Merlot, Marc Rayan, Martino Tattara, Spring 2004.*

Seria e figurave 29
 skema nga “Tirana paralele”: “dyzimi ideal” i qendrës ekzistuese, [projekt nga M Tattara]
 nga “Tirana metropolis” research report, Instituti Berlage 2004.





Seria e figurave 30


Skema të "Duranës", një mënyrë të menduari për Rajonin e Tiranës dhe të Durrësit si një qytet i vetëm, (projekt nga A Nurnberger, M Sobota dhe P P Tamburelli, nga "Tirana metropolis" research report, Instituti Berlage 2004

në formim" nënkuptonte një dimension të ri urban përmes koncentrimeve dhe shfrytëzimit të aseteve ekzistuese natyrale dhe urbane përgjatë aksit veri-jug si "shtylla kurrizore" që përshkon trajektoret e tre lumenjve: Lana, Tirana dhe Tërkuza. Në mënyrë të ngjashme studimi i "mënyrave të koncentrimit", bazuar në konceptin e arqipelagut, synonte të konfiguronte qendërsi strategjike jashtë qendrës ekzistuese të cilat do të shfrytëzonin "inteligjencën e vendit". Së fundmi, "Tirana Paralele" dhe "Durana" përcaktonin mundësi radikalisht të reja për zhvillimin e Tiranës dhe shkrirjen e Tiranës dhe të Durrësit në një metropol të ri.

"Tirana Paralele"⁴⁵ që supozonte "dyjëzimin ideal" të qendrës ekzistuese të qytetit ishte një ide tjetër, e cila ironizonte idenë fikse për t'i ardhur rrotull qendrës (seria e figurave 29). Sipas kësaj ideje, "epidemija e shpërhapjes urbane" nuk mund të ndalohej vetëm duke zhvendosur kufijtë / unazat e qytetit, por edhe duke marrë parasysh qytetin në shkallën territoriale reale.

⁴⁵ "Tirana Metropolis", fq. 114-123, projekti nga Martino Tattara, vepra e sipërcituar.

"Tirana Paralele" fokusonte vëmendjen 3 km nga Sheshi Skënderbej, në zonën midis unazës dhe shpërhapjeve urbane në drejtim të Durrësit, në verilindje. Sipas këtij vizioni, ky "qytet pasqyrë" formësohej nga "shpërhapjet" urbane që i ngjasonin një arqipelagu me forma të medha brenda një perimetri katror sa unaza ekzistuese e Tiranës dhe qarkohej nga rrugë, të cilat ndiqnin këtë formë. "Tirana Paralele" si "dublikim" i qytetit brenda unazës ekzistuese do të rikontekstualizonte idetë më të mira të tij. Identifikimi i tyre do të "mbartej" nga leximi i kujdesshëm i "potencialeve të fjetura" brenda qendrës së qytetit. Mbi këtë bazë u identifikuan: "qyteti labirint" që përkonnte me qytetin e origjinës organike të Tiranës; "qyteti kopsht" që është struktura "e fjetur" në zonën jug-perëndimore të Tiranës; "qyteti në blloqe perimetrale" që është parimi i ndërtimit të qytetit në pjesën perëndimore (blloku); ndërsa aksi kryesor, i cili kulmon me "Sheshin Skënderbej" përfaqëson një pëlhurë lineare të ndërtesave publike që sjell imazhin e "Akropolit" dhe të "qytetit të bërë me arkitekturë" (seria e figurave 20). Ky pro-




pozim është edhe një mënyrë se si mund të nxitet procesi i dendësimit të qytetit, por i bazuar në përcaktimin e principeve formale të qarta të zhvillimit të pëlhurave.

"Tirana Paralele", sikurse ajo "tradicionale", përshkohej nga lindja në perëndim nga Lumi i Tiranës dhe pingul me të nga një aks monumental që "riprodhonte" aksin e bulevardit. Në ndërprerjen e këtij aksi me linjën hekurudhore Tiranë-Durrës ndërtohej edhe një stacion i ri. Sheshi qendror, në paralelizëm me "Sheshin Skënderbej", ishte vendi ku takoheshin të gjitha elementet e qytetit. Ideja e "qytetit labirint" e aplikuar në qytetin paralel synonte që përmes elementeve të mobilimit urban të krijonte "oborre të papritura" në rrjetin e rrugëve të ngushta si "dhoma dite" në qiell të hapur. Ideja e "qytetit kopsht" aplikohet në shpërhapjet informate, duke i transformuar ato në një qytet këmbësor me njësi banimi brenda një "pylli të dendur", i cili krijohet në sipërfaqet e lira midis shpërhapjes së ndërtimeve. "Zona e Bllokut" ripropozohet në të vetmen zonë të lirë brenda "Tiranës Paralele" përmes një rrjeti blloqesh


katrore me oborre të brendshme. Referenca tipologjike e këtyre blloqeve shkonte tek "immeuble vilas" e Le Corbusier-it (1922), që nënkuptonte mbivendosjen e vilave njëra mbi tjetrën. Ndërsa një liqen që krijohet në një pjesë të zonës transformonte këto fragmente në një arqipelag të vërtetë ku miksoheshin banesa dhe shërbime publike. "Tirana Paralele" propozohet si një qytet këmbësor, që kombinonte parkimet e vendosura përgjatë unazës me transportin tramviar.

Një vizion edhe më i gjerë territorial ishte ai për "Duranen"⁴⁶ i cili e konfirmonte këtë si një rajon që mund të përmbushte endrrat e banorëve për identitet dhe jetë metropolitane, sidomos të atyre të afruar pas viteve '90 (seria e figurave 30). Përmes sistemeve të reja të shërbimit Durana krijonte një "kostelacion" të ri midis "qyteteve formale" dhe "qyteteve informale", si edhe "oazit të gjelbër" të kodrave në brendësi të metropolit. "Blloqet formuese" që përbënin Duranën ishin dy qytetet kryesore, dy kor-

⁴⁶ "Tirana Metropolis", fq. 124-135, projekti nga Alexa Nurnberger, Martrin Sobota dhe Peir Paolo Tamburelli, vepra e sipërcituar.



31.1



31.2



31.3

ridoret lidhëse, si edhe zona kodrinore në mes. Këto përbënin një sistem morfologjik kompleks, një “qytet unazor”, që përmbante situata urbane mikse dhe plotësuese ndaj njëra-tjetrës.

“Korridori verior” që përbëhej nga dy sisteme lineare paralele përgjatë autostradës Tiranë-Durrës dhe hekurudhës, supozohej të zhvillohej si një “qytet linear” intensiv i grupuar përgjatë stacioneve të linjës së metrosë, që do të lidhte të dy qytetet. Ai do të përmbante ngulime banimi dhe aktivitete mikse, si shërbime, sipërmarrje tregtare dhe industri të lehtë. Stacionet e linjës së metrosë: “farat metropolitane”, sipas mundësive të kontekstit do të luanin rolin e qendrave dhe do të shërbenin si fillesa për grupimin e shërbimeve dhe të hapësirave publike të komunitetit. Me rritjen e tyre “farat metropolitane”, si pjesë e sistemit urban, mund të konsideroheshin pjesë e rritjes së qytetit. Korridori jugor si me pak i urbanizuar supozohej të zhvillohej me zona banimi ishullore me dendësi të ulët për vetë specifikat ambientale të tij. Ky korridor përmbante gjithashtu një program të pasur aktiviteteve rekreative: hipodrom, stadium dhe fusha golfi, si edhe kinema, palestra, restorante dhe fusha sporti, të lidhura këto edhe me parkun e kodrave. Kështu “korridori jugor”, që lidhej me detin do të ishte “burimi i hapësirës dhe natyrës” për suburbet luksoze të Duranës. Gjatë këtij korridori nuk do të kishte zona industriale.

“Durana” solli në vëmendje edhe konceptin e parkut metropolitane, jo vetëm në aspektin funksional, por edhe atë ekzistencial që lidhej me një dimension të ri të përjetimit të raporteve të njeriut me qytetin dhe natyrën. Peisazhi i kodrave, i ullinjve

dhe rezervuareve që ofronte një zemër të gjelbër nuk ishte thjesht një boshllëk në mes të asgjësë, por përfaqësonte kontrastin midis metropolit dhe hapësirës së lirë. Në këtë aspekt ky ishte një park metropolitane, që mund të “përjetohej” e të përdorej dhe jo vetëm të shikohej. Kjo zonë përfaqësonte gjithashtu një ekuilibër midis afërsisë për ta arritur dhe “vështirësive” / paqartësisë për të hyre, që vinte nga pozicioni qendror, por njëkohësisht “i fshehur e sekret”. Përveç zonave ekzistuese të banimit, të cilat do të vazhdonin të ruanin “zhvillimin në formë kampusi”, këtu do të “depërtonin” edhe “meteoritet metropolitane”, që nënkuptonin zhvillime “pikësore” me objekte publike, si spitale, universitete dhe qendra kërkimore, të cilët do të zbatonin kushtëzime specifike në raport me peisazhin.

“Tirana Metropolis”, për herë të parë solli një metodologji dhe vizion alternativ frymëzues, që përfshinte që nga dimensionin e pëlhurës urbane e deri tek dimensionin territorial dhe leximi i tipareve topografike. Ky vizion i paraqitur në vitin 2004 pati sa forcë tronditëse, aq edhe emancipuese për ambientet profesionale, pasi solli një këndvështrim të ndryshëm nga ai tradicional që bazohej në rastin më të mirë në qasjen thjesht teknike. Gjuha metaforike e këtij vizioni tregonte se edhe programet e ndërhyrjeve në qytet mund të shprehnin “poezinë” e tyre, përkundrajt gjuhës “frenuese” dhe jo frymëzuese që përdorej rëndom. Ky aspekt vlerësonte një element të harruar të planifikimit urban, nevojën për të frymëzuar si profesionistët, ashtu edhe pjesëmarrësit në proces. Kjo ndihmoi të kuptohej se edhe në situatat me të degraduara, çelësi i suksesit gjendej në “leximin

e kujdesshëm” të situatave të “fjetura”. “Tirana Metropolis” nuk ishte as vizion utopik dhe as projekt teknik, por synonte të vendoste Tiranën në raport me universin e marrëdhënieve, prej nga mund të buronin mundësi të reja të paeksploruara më parë.


Tirana midis konkurseve ndërkombëtare dhe marketimit të qytetit.

Duke filluar nga viti 2004 e deri më sot, në pamundësi për të hartuar plane gjithëpërfshirëse Tirana ka ndërmarrë disa plane pjesore. Këto shënojnë edhe fillimin e “erës” së konkurseve ndërkombëtare në Tiranë e në Shqipëri. Ndër më kryesorët ka qenë konkursi për masterplanin e zonës qendrore të Tiranës në vitin 2004, i fituar nga “Architecture Studio” (seria e figurave fq. 62 -63, 73). Në fazën përfundimtare të këtij konkursi morën pjesë edhe studio, si “Mecanoo” (seria e figurave fq. 65) dhe “Boles and Willson” (seria e figurave fq. 64). Ky projekt synonte lexueshmërinë e siluetës qendrore në një Tiranë që tashmë ishte rritur në lartësi. Ritrajtimin e aksit qendror si aksin nga ku natyra “hynte” dhe “shprehej” në qytet. Kompaktësimin e ndërtimeve në zonat qendrore përmes tipologjive të ndërtimit me blloqe të mbyllura. Krijimin e një sheshi dhe të një terminali të ri në zonën e stacionit të trenit etj. Ndërmarrja e disa veprimeve të kufizuara në përputhje me këtë plan dhe pa patur një vizion në shkallë qyteti pati impakte jo të mira në qytet, siç ishte p.sh., dështimi i këmbësorizimit të qendrës apo edhe të “bllokut” pasi nuk kishte një ide mbi skemat e trafikut në shkallë qyteti, apo edhe një ofertë të parkimeve publike


në zonën qendrore. Vitet në vazhdim vunë në diskutim shumë propozime nga ky plan. Disa pjesë të rëndësishme të tij siç ishte “Sheshi Skënderbej” u bënë përsëri pjesë e konkurseve ndërkombëtare pa qartësuar përse propozimet e këtij plani nuk ishin më të vlefshme. Por ajo që duket se ende ka mbetur nga ky plan, janë kullat që konturojnë siluetin e qendrës.

Periodha në vazhdim u pasua nga një sërë konkurseve ndërkombëtare që trajtonin pjesë të qytetit apo objekte të veçanta, ndër të cilët: konkursi ndërkombëtar për “Sheshin Skënderbej” (seria e figurave fq. 74-75,108-11), për zonën pranë digës së liqenit “Tirana Rocks” etj. (seria e figurave fq. 114-115,122-123), për disa zona prioritare të Tiranës (98-129), për objektet e kullave që propozonte masterplani i qendrës (seria e figurave fq. 76-79,80-82), dy konkurse ndërkombëtare për ndërtesën e Parlamentit (seria e figurave fq. 84-85), për xhaminë e re të Tiranës (seria e figurave fq. 86-87) etj. Kjo qasje e transformimit të qytetit mbi bazë projektesh që nuk mbështeten nga një vizion në shkallë qyteti, qoftë ky edhe në “vija të trasha”, ka lënë gjurmë të fragmentimit në Tiranë.

Shumë nga projektet e hartuara nga këto konkurse, meqenëse ishin të hartuara nga studio me reputacion ndërkombëtar, më shumë se sa vlerën e vërtetë të zbatimit patën efektin e marketimit të qytetit. Tirana ishte futur tashmë në axhendën e të ashtuquajturve “star architects”. Këto fenomene të reja meritojnë një artikull të veçantë, ndërsa disa nga projektet më të rëndësishme të kësaj faze ilustrohen në vazhdim.



32.1



32.2

Seria e Figurave 32

Skema nga tentativat për hartimin e planit rregullues të vitit 2006. Bashkia Tiranë dhe Urbaplan, “urban regulatory plan Tirana, final report”, December 2008



32.3




32.4


Seria e figurave 31 - 32 Skema nga tentativat për hartimin e planit rregullues të vitit 2006. Bashkia Tiranë dhe Urbaplan, “urban regulatory plan Tirana, final report”, December 2008

- 31.1 Koncept hapësinor i zhvillimit të Tiranës
- 31.2 Qendrat dhe nënqendrat në Tiranë
- 31.3 Koncept i zhvillimit të hapësirës Tiranë-Durrës
- 32.1 Përdorimi i propozuar i tokës për vitin 2020
- 32.2 Elementet kryesore natyrore: topografia, hapësirat e gjelbra, lumenjtë dhe liqenet
- 32.3 Propozimi për rrjetin rrugor kryesor
- 32.4 Zonat prioritare të ndërhyrjes


Tentativa e planit 2006.




32.5 Fazat e shtrirjes hapësimore të Tiranës



32.6 Pëlhurat urbane ekzistuese



32.7 Zonat me ndërtim informale



32.8 Dendësia bruto e popullsisë sipas sektorëve

Tentativa më e fundit për të hartuar një plan të përgjithshëm rregullues të Tiranës është ajo që zë fill në vitin 2006. “Odiseja” e këtij plani filloi që në fazën e kontraktimit të studios fituese për shkak të shfazimit në kohë më shumë se një vit nga kryerja e konkursit në kontraktim. Ky plan i hartuar në Bashkinë e Tiranës, i asistuar nga studio zvicerane “Urbaplan” (studio e cila zuri vendin e tretë në konkurs) dhe i asistuar vetëm në fazën analitike nga Co-PLAN-i, nuk arriti dot miratimin zyrtar deri në vitin 2010. Kjo jo vetëm për shkak të varfërisë së propozimeve që përmbante materiali përfundimtar, por edhe për shkak të politizimeve të tejskajshme. Në këto kushte duket se hartimi i planit të përgjithshëm rregullues mbetet ende sfidë për Bashkinë e Tiranës. Në se ky plan do të mbështetet në punën dhe konkluzionet e arritura nga plani i mëparshëm i pamiratur, kjo ende nuk dihet. Megjithatë, është me interes të shtrojmë këtu disa nga propozimet e këtij plani tentativë për të kuptuar në se sjellin ndonjë risi në historinë e planeve të Tiranës.

Nga pikëpamja konceptuale dhe formale ky plan duket se nuk sillte pothuajse asgjë të re përveçse ripërmbledhte dhe rishikonte konceptet e planit të vitit 1989 (seria e figurave 18 dhe 32). Nga ana tjetër ky plan nuk u mbështet në disa nga propozimet e rëndësishme të studimeve të mëparshme si p.sh., të Planit Strategjik të Tiranës së Madhe sa i takon ideve të skemës së zhvillimit të qytetit dhe të transportit të bazuar jo vetëm në unaza, por edhe në orbitale; të planit të vitit 1989 për vazhdimin e bulevardit; të vizionit Tirana Metropolis sa

i takon ideve të konsolidimit të zonave ekzistuese në periferi të Tiranës e përtej, bazuar në një qasje kontekstuale dhe “metaforën” e paralelizimit, apo në një shkallë më të madhe të Duranës.

Plani parashikonte rritjen e popullsisë së Tiranës nga viti 2005 deri në vitin 2020 sipas tre skenarëve (Urbaplan International, 2008): me rritje të lartë (1 225 932 banorë); me rritje të mesme (1 047 988 banorë) dhe me rritje të ulët (795 243 banorë); dhe propozonte si më të mundshëm skenarin me rritje të mesme, sipas të cilit, popullsia e Tiranës në fund të periudhës së parashikimit (2020) do të rritej me 3.37% në vit nga 4.44% në vitin 2010, ose me një shtesë 400 000 banorë krahasuar me vitin 2007⁴⁷. Për këtë plani inkurajonte në radhë të parë dendësimin e zonave ekzistuese për të kontrolluar shtrirjen urbane. Për të balancuar rritjen e popullsisë me vendet e punës plani propozonte dyfishimin e sipërfaqeve për aktivitete magazinuese, industriale dhe tregtare. Për këto zona perëndimore paraqiste mundësi për mbushje dhe dendësim veçanërisht zona e aeroportit të vjetër. Po ashtu edhe zona veriore sidomos pranë stacionit të vjetër të trenit, zonat e mëparshme industriale dhe përgjatë lumit të Tiranës. Zona jugore dhe ajo lindore paraqesnin me pak mundësi⁴⁸.

Plani parashikonte për vitin 2020 një skemë policentrike brenda vijës administrative me një sistem qendrash sekondare

47 *Urbaplan International: Urban Regulatory Plan Tirana, Final Report, Document No.1, fq. 12, December 2008*

48 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 36.*

përgjatë unazës së madhe në kryqëzimet me rrugët radiale⁴⁹. Mungesa e koordinimit real me komunat fqinje bëri që policentrizmi të redukohej në një shkallë shumë të vogël (brenda unazës) dhe ideja që vetë plani paraqeste në skicat fillestare për një skenar të shpërndarjes së popullsisë sipas korridorit Tiranë-Durrës⁵⁰ të bëhej e pamundur (seria e figurave 31). Në lidhje me parashikime të tjera përtej kufijve administrativë, ky plan rikonfirmonte tri parqet: të “Liçenit”, të “Farkës” dhe të “Paskuqanit”⁵¹, si edhe elementet natyrore: korridorin e lumit të Tiranës dhe kurorën e kodrave në verilindje, lindje dhe jug⁵². Ndërtimet në këto kodra do të kufizoheshin sipas kuotës, tipit të pjerrësisë, ndërtimeve ekzistuese, llojit të zhvillimit, rrugëve etj. P.sh., në kodrat e Kasharit kuota maksimale e ndërtimit do të arrinte në 100 m, ato të Paskuqanit 150 m, ndërsa në kodrat e Dajtit dhe të Farkës në 200 m⁵³. Edhe pse plani propozonte “vijën e interesit të përbashkët”⁵⁴ku përfshiheshin terriore jashtë Bashkisë së Tiranës por me interes reciprok për vendimarrje të koordinuar, kjo marrëveshje nuk arriti të nënshkruhet. Këta kufij u kthyen në “muresjetare” edhe për shkak të marrëdhënieve tejet të acaruar që ekzistonin midis

49 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 24.*

50 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 29.*

51 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 14, 17, 51.*

52 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 24,25.*

53 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 49-50.*

54 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 58, (“line of concern”).*

Bashkisë së Tiranës dhe disa prej komunave fqinje.

Plani rikonfirmonte rëndësinë e përfundimit të unazës së madhe,⁵⁵së pari, të segmentit jugperëndimor që lidh rrugën e Kavajës me atë të Elbasanit (aktualisht në zbatim), së dyti, segmentin verior nga Rruga e Durrësit tek ajo e Dibrës sipas drejtimit të lumit të Tiranës dhe së treti, segmentin Lindor nga Rruga e Dibrës tek ajo e Elbasanit⁵⁶ (seria e figurave 33); Plani rikonfirmonte si zona prioritare zhvillimi të dyja anët e rrugës së Durrësit deri tek kthesa e Kamzës, si edhe fashën nga stacioni i trenit deri në ndërprerjen me korridorin e Lumit të Tiranës. Në dallim nga planet e viteve 1989 dhe 2001, ky plan nuk propozonte zgjatjen e bulevardit, por përmirësimin e dy rrugëve ekzistuese paralel me binarët hekurudhorë nga unaza në drejtim të lumit të Tiranës. Plani propozonte stacionin e trenit në vendin ekzistues, si edhe dy zona rezervë: në ndërprerjen e aksit verior me lumin e Tiranës dhe në afërsi me kthesën e Kamzës. Terminale të tjera të rëndësishme propozoheshin në Aeroportin e Rinasit dhe njëjën e Bërçullës e të Kombinatit⁵⁷, të cilat krijoheshin në ndërprerjen e linjave Bërçull-Kombinat, Bërçullë-Rinas (Aeroport). Në kushtet e rritjes së numrit të automjeteve nga 70 000 në vitin 2007 në 300 000 në vitin 2020 (gjysma e përqindjes së pronësisë në vendet e Evropës)⁵⁸, plani rekomandonte

55 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 36.*


56 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 32, 87,88.*

57 *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 52, fig. 8, fq.53.*

58 *Urbaplan International, dokumenti i*

Seria e figurave 33

Plotësimi i skemës së rrjetit rrugor sipas fazave, hierarkia e rrjetit rrugor të propozuar për Tiranën, Urbaplan dhe Transitec



një politikë të transportit publik me autobuza dhe tram nga qendra e Tiranës në atë të Durrësit, si edhe parkime publike. Linja e tramvajit do të lidhte Universitetin e Kamzës me atë të Tufinës⁵⁹. Plani shtronte nevojën për përmirësimin e aksesit në shërbime publike, si spitalet, ndërtimin e 17 shkollave të reja, ndërtimin e një kampusi të ri etj.

Drejt cilës Tiranë?

Në këtë pikë, është e rëndësishme të kuptojmë se në cilën fazë të zhvillimit si qytet ndodhet Tirana. Historia tregon se struktura e shumë qyteteve fillon në mënyrë monocentrike dhe gradualisht aktivitetet që gjenerojnë udhëtimet drejt tyre shpërhapen dhe krijojnë grupime jashtë qendrës tradicionale. Në këtë kuptim Tirana e sotme kërkon një refleksion në shkallë territoriale. Bertaud A. (2001) shkruan se struktura hapësimore e një qyteti mund të përcaktohet nga dy komponente⁶⁰: shpërndarja hapësimore e popullsisë dhe rrjeti i udhëtimeve nga banesa në vendet e punës, shkolla, zona tregtare apo çdo vend tjetër që simbolikisht quhen “pika takimi”. Në një qytet me strukturë monocentrike këto “pika takimi” janë kryesisht të vendosura në zonën qendrore, ndërsa në një strukturë policentrike shumica e pikave të takimit janë të vendosura në “grupe” të shpërndara përreth zonës metropolitane. Pra, me rritjen e madhësisë struktura monocentrike shfaq tendencën që gradualisht të shkrihet në strukturë policen-

sipërcituar, fq. 15.

⁵⁹ *Urbaplan International, dokumenti i sipërcituar, fq. 52.*

⁶⁰ *Bertaud Alain (2001), “Metropolis: the spatial organization of seven large cities”, tek Time-saver Standards for Urban Design, fq. 1.2-1 – 1.2-4, botues Watson Donald, Plattus Alan, Shibley Robert, Mc Graw-Hill, 2001.*

trike. Sipas “Charter of New Urbanism”⁶¹, metropoli përbëhet nga shumë qendra që janë qytete të mëdha e të vogla, secili me qendra dhe kufij të dallueshëm (Calthorpe dhe Fulton 2001).

Kjo është “dilema” aktuale ku ndodhet Tirana. “Shkëputja” e qendrave të reja jashtë kufirit administrativ të Tiranës, si Kamza, Vora, Fushë-Kruja etj. pengohet nga mundësitë e kufizuara të lidhjeve me transport publik kualitativ. Do të mjaftonte një vëzhgim i shpejtë për të kuptuar se jo vetëm Tirana, por edhe qytetet e tjera të Shqipërisë janë ende “ndajshesa” të magnetizmit ekstrem të “qendrës”. Strukturat fizike të tyre “druajnë” të fitojnë mëvetësi dhe identitet nga “akset prurëse” origjinale të fillësive të qytetit. Në Tirane, “Skenderbeu” është ende “garanti” i këtij “kohezioni” fizik të sforcuar edhe pse forcat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror e kanë bërë shkohezionin territorial një realitet për Rajonin e Tiranës së Madhe.

“Leximi” dhe zhvillimi i këtyre tendencave përmes projekteve për strukturimin e koncentimeve, do të bënte që “periferizimi” aktual i “Tiranës së Madhe” të kthehej në një sistem policentrik me qendra, që plotësojnë dhe mbështesin reciprokisht njëra-tjetrën. Kjo mund të realizohet vetëm përmes përdorimit të mjeteve dhe mënyrave të reja të transportit publik p.sh., tram, autobus, trena, metrobus etj. që do të “magnetizonin” dhe integronin fragmentet urbane në një arqipelag që ruan entitetet dhe funksionon i ndërlidhur. Përforsimi i këtyre qendrave do të “çlironte” Tiranën, duke krijuar më shumë vend për hapësira publike dhe do të përforconte identitetin e qendrave të reja me rigrupimin e disa shërbimeve

⁶¹ *referenca*

dhe aktiviteteve prodhuese. Vetëm në këtë rast nuk do të përbente më dallim thelbësor se “ku banon”, pasi shpejtësitë dhe mjetet e reja të lëvizjes do të garantonin vendndodhjen tonë të dëshiruar në kohe dhe në hapësirë. Këto procese kanë ndodhur më parë në shumicën e qyteteve të zhvilluara të Europës.

Pasi u analizuan disa nga idetë kryesore dhe konceptet teorike, që kanë synuar të drejtojnë Tiranën që prej themelimit e deri më sot, mund të kuptojmë më mirë se deri në ç’masë Tirana është rezultat i ndërveprimit të projekteve / modeleve me spontaneitetin njerëzor; mund të kuptojmë mënyra alternative se si mund të “rikapim formën” tashmë të shpërhapur dhe se si kaosin mund ta “përkthejmë” në kompleksitet struktural të ndërgjegjshëm mbi bazën e leximit dhe përforsimit të pëlhurave urbane, si edhe të prirjeve specifike të territorit dhe strukturimit të qytetit mbi këtë logjikë; mund të kuptojmë ndërhyrjet për të kaluar drejt një qyteti që krijon mundësi në rritje, si psh. krijimin e qendërve të reja si pjesë e një metropoli, cili funksionon si i tillë jo vetëm fizikisht, por dhe nga manaxhimi i shërbimeve, përcaktimet strategjike të përdorimeve të tokës përfshirë zonat prioritare të zhvillimit ekonomik, si edhe skemat rrugore e ato të transportit publik në përputhje me to, e shumë të tjera të cilat janë përmendur më sipër. Të gjitha këto krijojnë Tiranën midis “ëndrrës dhe realitetit”, Tiranën që nuk pushon kurrë së befasuari me cilësinë e saj për të ndryshuar midis rregullit dhe kaosit.



Seria e figurave 34


Pamje nga ekspozimi i dokumentit të hartuar për planin rregullues të Tiranës në vitin 2008.



Foto: Sotir Dhano

Konkursi për masterplanin e zonës qendrore të Tiranës, 2004
projekti fitues i konkursit i paraqitur nga "Architecture Studio", Francë





SLIPPED LOOPS
+ NETWORK



TRAFFIC CONCEPT + NETWORK

Konkursi për masterplanin e zonës qendrore të Tiranës, 2004
varianti i projektit i paraqitur nga studio Bolles and Wilson, Gjermani



Konkursi për masterplanin e zonës qendrore të Tiranës, 2004
Varianti i projektit i paraqitur nga studio Mecanoo Architecten, Hollandë

Edhe njëherë për Projektin “Ti-Rama”

nga Besnik Aliaj

Sfondi

Shqipëria postkomuniste ka kaluar në disa faza të spikatura të zhvillimit social-ekonomik-kulturor dhe politik, ku bien në sy ulje- ngritjet radikale, të cilat kanë impaktuar seriozisht mentalitetin e shoqërisë dhe modelin e jetesës, duke imponuar ndryshime edhe në mënyrën se si është zhvilluar arkitektura dhe urbanistika. Në mënyrë të veçantë zona metropolitane është futur në një spirale zhvillimi sa entuziaste e kreative, aq edhe komplekse në problematikën e saj. Tirana është në fakt platforma, ku ndërthuren më dukshëm këto zhvillime interesante, përtej kontekstit shqiptar.

Gjatë komunizmit, arkitektura dhe urbanistika shqiptare, ishin në një “luftë të hapur” me iniciativën private dhe kufizoheshin shumë nga izolimi dhe ideologjizimi i tepruar. Tipari domethënës i kësaj periudhe ishte aplikimi i parimeve moderniste sipas një versioni lokal, shpesh primitive, ku strukturat historiko-organike spastroheshin dhe zëvendësoheshin me komplekse moderniste, ku volumet e thjeshtëzuar urbanistiko-arkitektonike shoqëroheshin me reduktime drastike të koncepteve,

kostove, instrumentave, detajeve dhe teknikave. Lartësia maksimale ishte 4-6 kate, ndërsa tipologjitë zotëruese ishin zonat e banimit, qendrat administrative, zonat industriale-ekonomike, etj.

Pas rënies së *Murit të Berlinit*, si Shqipëria në tërësi, edhe Tirana hynë në një fazë ndryshimi radikal, gati traumatike në kushtet e aplikimit të parimeve të “Shock Therapy”, si rruga e vetme e daljes nga kriza e thellë që kishte kapur vendin (1990-1996). Kjo u shoqërua me reforma radikale, si privatizimi i tokës bujqësore dhe strehimit urban, njohja e të drejtës së pronës, lëvizja e lirë dhe iniciativa private. Këto reforma dhanë rezultatet e para të rritjes ekonomike, të cilat në kushtet e mungesës së përvojës në ekonominë e tregut, pësuan deformime dhe dështime, që kulmuan me zhvillimin dhe rënien e skemave financiare “piramidale” (1996-1997). Këto të fundit, të cilat u shoqëruan nga revolta masive popullore si dhe futja e vendit në një gjendje anarkie dhe kaosi mundi të kontrollohej nga autoritetet vetëm pas ndërhyrjes ndërkombëtare dhe sidomos pas përfundimit të krizës së refugjatëve, për shkak të luftës së

Kosovës (1999). Gjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin, por sidomos në Tiranë lulëzuan ndërtimet informale për qëllime strehimi dhe sipërmarrje ekonomike. Të parat ishin refleksi i nevojës për strehim të trashëguar nga e kaluara dhe nga lëvizjet migratore, kurse të dytat ishin produkt i nevojës për punësim, rritjes ekonomike, por shpesh edhe për qëllime spekulative, spekulim që u shtua edhe më shumë pas viteve 90-të.

Bashkia Tiranë

Siç përmendet më lart, gjatë viteve ‘90-të Tirana u përballë me tri kriza të forta politike: *ndryshimi i sistemit politik, kriza e piramidave financiare dhe kriza e refugjatëve të luftës në Kosovë*. Administratorët publikë të kryeqytetit: Kryetari i parë i Bashkisë Pluraliste, Sali Kelmendi dhe më pas Albert Brojka (Partia Demokratike), u përballën me një situatë të vështirë emergjencash sociale-ekonomike, ku planifikimi urban dhe arkitektura nuk ishin absolutisht prioritet. Për më tepër, pushteti lokal sapo ishte rithemeluar dhe mungonin kompetencat dhe financat

më bazike. Legjislacioni i vjetër ishte në ndryshim të shpejtë dhe të vazhdueshëm. Mungonin përvoja dhe stafi për të bërë ndryshime thelbësore në infrastrukturë e shërbime në kushtet e reja social-ekonomike. Aktiviteti ndërtimor ishte tepër i kufizuar dhe kryesisht informal. Iniciativat e para planifikuese të përkrahura nga Qeveritë Amerikane (Structure Plan), Japoneze (Drainage & Sewerage Plan) dhe Austriake (Regulatory & Transport Plan) gjatë periudhës 1994-1996, për fat të keq u ndërpreën ose nuk u morën në konsideratë më pas.

Edi Rama dhe vitet 2000

Në këtë situatë “mbijetese” të viteve ‘90-të, në fushatën elektorale të zgjedhjeve lokale spikat fitorja e Edi Ramës, një piktor me profesion dhe intelektual e komentues aktiv gjatë viteve të para të ndryshimit të vendit. Pas një periudhe të parë, ku u profilizua si oponent i autoriteteve (1988-1996) dhe një periudhë ekzili politik dhe profesional, Rama rikthehet në Tiranë si Ministër i Kulturës (1998-2000), i ftuar nga lideri socialist i mazhorancës së



Besnik Aliaj - Co-founder, and Dean of POLIS University. Graduated as Architect-Urban Planner (Polytechnic University of Tirana). Postgraduate studies in real estate (UPT). Diploma “Master in Urban Management” (Urban Management Center, IHS / Erasmus University, Rotterdam, Netherlands). Doctor of Science in Urban Planning (UPT). Professional trainings and scientific research near IPC College Denmark (1994), University of Oslo (1995), University of Florence, Tempus Program (1998), etc. Work experience at local governments 1990-92. 16 years as lecturer at the Faculty of Civil Engineering (UPT). Guest lecturer at the Academy of Fine Arts of Tirana (1994-2005). Co-founder and Executive Director of Co-PLAN, Institute for Habitat Development (1997-2005). Work experiences with local/regional/central government institutions, and with international organizations. World Bank, UN, UNDP, UN Habitat, FAO, OSCE, SOROS, GIZ, AIZ, IHS Rotterdam, ILO-Peru, and with governments of the Netherlands, USA, Austria, Kosovo, etc. Adviser of Albanian Prime-minister on territorial, tourism and property issues (2005-2007). Co-owner of architecture bureau ‘Metro_POLIS’ Ltd. Participant in many international conferences, events and networks, including ENHR, AESOP, AEEA, Balkanology network, etc. Author of several publications, scientific articles and local forums, including the Albanian periodical on architecture and urban planning, “Forum A+P”.

kohës, Fatos Nano (Partia Socialiste), duke rihapur shpesh debate dhe reagime publike kundërshtuese midis institucioneve të artit dhe kulturës në vend, sidomos në rastin e reformave të Operas dhe Baletit, Galerisë së Arteve, Teatrit Kombëtar, etj. Projekti i tij kulmor “Kthim në identitet” për rehabilitimin e kompleksit të ministrive, ndërtuar gjatë periudhës së monarkisë, u bë jo vetëm demonstrimi kryesor elektoral i platformës së tij për Tiranën, por edhe një debat i ashpër publik dhe profesional mbi mënyrën se si duhen realizuar programet e rehabilitimit dhe konservimit urban. Sidoqoftë kjo ndërhyrje do të ishte një pikë kthese për transformimin e qytetit më pas dhe për ndryshimin e mentalitetit të qeverisjes urbane në tërësi për vendin. Falë saj, politikanët shqiptarë kuptuan impaktin e madh të projekteve arkitektonike dhe urbanistike mbi qytetarët dhe sidomos votuesit. Rama do të bëhej kështu, aplikuesi më klasik i kësaj filozofie, për rreth një dekadë, duke korrur tre beteja elektorale kundrejt rivalëve demokratë: *e para* në vitin 2000, mjaft vështirë, por e denjë me Besnik Mustafaj; *e dyta* në 2003, jo pak e kontestuar, me juristin Spartak Ngjela; *e treta* në 2007, një fitore e thellë e papritur, por më shumë një fitore konjunkturale politike me ish ministrin e brendshëm Sokol Olldashi. Saga 11 vjeçare mbyllet me humbjen e ngushtë në zgjedhjet e vitit 2011, me ish ministrin e punëve publike Lulzim Basha... Ndërkohë Edi Rama, që në vitin 2005, ishte bërë lideri i opozitës dhe, që atëherë synonte të bëhej Kryeministër i Shqipërisë dhe të zbatonte idetë e tij në nivel kombëtar.

Projekti “Ti-Rama” dhe Qyteti

Edi Rama, fillimisht u bë i njohur me projektin e lyerjes së fasadave. I ardhur në krye të Bashkisë në vitin 2000, si ish-ministër, ai do të konstatonte varfërinë ekstreme në kompetenca dhe burime të këtij niveli qeverisje. Por nevoja për të performuar në një mandat ekstremisht të shkurtër dhe në një situatë sociale depresive, gati e pashpresë, ai ishte i detyruar të performonte me projekte të vogla, pa kosto dhe me impakt maksimal. Background-i si artist i stimuloi kreativitetin dhe në mënyrë instiktive, ai, kap një mundësi të ofruar nga një projekt i FZSHH-së, financuar përmes BE-së, për të rehabilituar rrugën e Durrësit: asfalt, trotuare, mbjellje pemësh dhe natyrisht rehabilitim dhe lyerje të fasadave. Me gjithë impaktin pozitiv të këtij projekti, nuk munguan as kritikrat e drejta, ku duhet të veçojmë, debatin me arkitektin e mirënjohur Petraq Kolevica, i cili ngriti çështjen e të drejtave të autorit, sidomos në rastet e objekteve me vlera, që i përkasin rrymës së modernizmit në Shqipëri (Pallati prapa Bankës, rruga e postës, etj).

Por, projekti kulmor për suksesin e tij gjatë mandatit të parë, do të ishte prishja e ndërtimeve pa leje në Parkun Rinia dhe hapësirën përgjatë 4 kilometrave të lumit Lana. Ky operacion hasi në fazat e para në protesta të ‘pronarëve’ informalë të objekteve, që gjeti më pas një mbështetje të fortë të opinionit publik, i cili tashmë ishte lodhur nga kaosi urban, pasi informaliteti e kishte kaluar fazën e nevojës dhe ishte bërë më shumë një spekulim. Sidoqoftë, duhet thënë se ky operacion

urbanistiko-mjedisor, rezultoi mjaft i kushtueshëm për financat bashkiake dhe pa mbështetjen e qeverisë qendrore do të kishte qenë pothuajse i pamundur. Suksesi i rehabilitimit të hapësirës urbanistike të lumit të Lanës u pasua edhe më tej nga rregullimi dhe lyerja e fasadave, rikthimi i gjelbërimit dhe trotuarëve për këmbësorë. Operacionet e kësaj natyre u kryen më pas edhe në arteriet kryesore të qytetit, si Rruga e Kavajës, Rruga e Elbasanit dhe Rruga e Dibrës, Bulevardi dhe Unaza, ku praktikisht u operua me zgjerimin e rrugëve, ndarjen me korsi me sens unik, mbjelljen e pemëve, pa harruar dhe rehabilitimin e fasadave.

Kjo e fundit u kthye gati në një mani, shpesh të ekzagjeruar, pa mohuar edhe faktin se gjatë kësaj dekade të fundit u ftuan në Tiranë mjaft artistë të huaj dhe vendas me reputacion ndërkombëtar, duke bërë që disa prej fasadave të rehabilituara të kthehen në vepra të mirëfillta arti, të cilat duhet të meritojnë vëmendjen e autoriteteve, për t’i mbrojtur ato edhe në të ardhmen. Por, nuk mund të mohohet as fakti, që përtej entuziazmit dhe atmosferës pozitive që solli projekti i fasadave, në thelb ai përfaqësoi filozofinë e projektit Ti-Rama, i cili edhe pse mjaft kreativ, mbeti disi sipërfaqësor. Edhe konkurset ndërkombëtare të arkitekturës dhe urbanistikës, që u organizuan nga viti 2003-2011, mbetën viktimë e këtij mentaliteti, që u mishërua sidomos në projektin fitues të konkursit të parë, mbi masterplanin e qendrës së qytetit në vitin 2003, nga Architecture Studio, Paris. Ky projekt edhe pse në një farë mënyre është historik, përfaqësoi një koncept

urbanistik butaforik, i cili nuk merrte në konsideratë regjimin e pronësisë në këtë territor, duke diskriminuar një pjesë të komunitetit dhe favorizuar pjesën tjetër, sepse bazohej më shumë tek menaxhimi i qytetit mbi bazën e parcelave/interesave të veçanta/individuale dhe jo të qelizave të qytetit dhe interesit të plotë publik. Pa folur, për ekzagjerimin e panevojshëm të sprawl-it vertikal të qytetit me ndërtime shumë katëshe, ku spikasin 12 kulla 25-katëshe përgjatë bulevardit kryesor, të pajustificuara për përmasat e tregut imobiliar vendas. Koha ka dëshmuar se, ndërtimi i këtyre kullave, jo vetëm që nuk ishte realist për tregun e vogël të Tiranës, por kontribuoi për rëndimin edhe më keq të krizës së pasurive të patundshme, që u akumuluan në atë kohë. Madje edhe ato kulla që janë të ndërtuara mbeten ende të pa okupuara plotësisht.

Në vijim të kësaj logjike, edhe pse arkitektët e huaj luajtën një rol shumë pozitiv në fazën e parë, sidomos për edukimin e publikut dhe të komunitetit lokal të arkitektëve, që mbarte komplekset e izolimit të së kaluarës, nuk mund të mohohet gjithashtu se, mungesa e prezencës së arkitektëve vendas, ose diskriminimi i tyre në proces/akses pjesëmarrjeje e përkeqësoi edhe më keq situatën e konkurrencës së pandershme profesionale. Madje duket sikur pjesëmarrja e studiove dhe arkitektëve të huaj ka qenë më shumë një lloj alibie për të justifikuar interesat e ngushta lokale të zhvillimeve të caktuara. Kjo bëhej edhe më kritike nga fakti që, komuniteti i atyre që merrnin pjesë në konkurse dhe atyre që vlerësonin fituesit vërtitej pothuaj tek të njëjtit njerëz duke ricikluar një grup

interesash, me jo më shumë se 30-50 profesionistë. Në vitet e fundit të dekadës së viteve 2000, nuk munguan as ndërhyrjet në brendësi të blloqeve dhe kuartalleve të ndërtimit, duke korrigjuar disi efektin e aq komentuar “fasadë”. Por, përtej këtyre kritikave, duhet thënë se projekti Rama, pati në përgjithësi sukses, sidomos për sa i përket ndriçimit të qytetit, transportit bazë publik, hapësirave kryesore publike dhe mbi të gjitha shndërrimit të imazhit ndërkombëtar të Tiranës në një kontekst gjithnjë e më pozitiv dhe shembull për bashkitë e tjera të vendit dhe rajonit.

Ana tjetër e medaljes

Duhet thënë se, Projekti Ti-Rama ndërtohej mbi bazën e një marrëdhënieje mjaft të diskutueshme që politika shqiptare ka me mediat, shumë prej të cilave më tepër se sa vlerësonin realisht punën e tij ose të politikanëve të tjerë, kishin interesa të drejtpërdrejta ekonomike, që lidheshin me zhvillime të caktuara të qytetit, sidomos në sektorin e ndërtimit. Por Rama dështoi veçanërisht me hartimin dhe miratimin e planit të shumëpritur rregullues të qytetit, i cili ishte premtuar të realizohej brenda mandatit të parë. Edhe pse një draft i këtij plani, më në fund, u draftua në mandatin e tij të fundit, ai nuk arriti kurrë të bëhej pjesë e interesave të përgjithshme të qytetit dhe aq më pak nuk arriti të miratohej, pasi nuk mundi të bëhej pjesë e një procesi transparent, ku interesat publike të balancoheshin me ato ekonomiko-politike. Kjo solli në kthim bllokimin politik të procesit.

Më tej, Rama pati një qëndrim

kritik ndaj trajtimit të çështjes së pronave në Shqipëri, por nga ana tjetër, ai vetë asnjëherë nuk dëshmoi vullnet për të kompesuar subjektet private, që u cënuan nga projektet e zhvilluara gjatë dekadës së qeverisjes së tij në Tiranë. Ky dështim në lidhje me planifikimin e qytetit vinte sa nga mungesa e vullnetit politik për të qeverisur me rregulla dhe vizion të qartë, aq edhe nga refuzimi i pajustificuar për të mos unifikuar procesin e planifikimit dhe zhvillimit të Bashkisë Tiranë me njësitë e tjera vendore fqinje, të cilat praktikisht funksionin së bashku, si një organizëm i vetëm metropolitan. Ai nuk e përdori karizmën e tij publike dhe politike përtej kufijve administrativë të bashkisë së tij për të krijuar një autoritet modern metropolitan zhvillimi dhe pothuajse, injoroi rolin e tij, si kryetar i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe aq më tepër, stimuloi përçarjen e kësaj shoqate gjatë mandatit të tij të fundit për arsye banale politike të momentit, duke i dhënë një goditje të panevojshme lobimit në favor të decentralizimit dhe që me shumë gjasa do t'i bëhej vetë atij boomerang më vonë në një karrierë të tijën potenciale në qeverisjen qendrore.

Duhet thënë edhe se, pas mandatit të tij të dytë, ai u fokusua më shumë në rolin e tij të ri, si lider i opozitës dhe në politikën kombëtare, gjë që e dobësoi performancën e vetë Bashkisë së Tiranës, pavarësisht se i takon merita e padiskutueshme e ngritjes së një stafi tërësisht të ri, të kualifikuar dhe energjik, por nga fundi pa një leadership të qartë dhe të pa votuar politikisht. Edhe marketimi i shkëlqyer që iu bë qytetit, përfshi një sërë çmimesh ndërkombëtare,

apo çmimin si Kryebashkiaku i vitit 2004 nga OKB, nuk u maksimalizua në tërësi në funksion të qytetit, por më shumë në dobi të profilit personal politik individual të Ramës. Ai stabilizoi një regjim gati autoritar ‘lejesh ndërtimi’, të cilat politizuan dhe densifikuan qendrën e qytetit në nivele të panevojshme dhe shpesh të pajustificueshme, duke theksuar segregimin social dhe ekonomik midis qendrës dhe periferisë së qytetit. Kjo politikë, do të jepte pasoja dhe deformime edhe në njësitë e tjera vendore dhe fqinje me Tiranën.

Ndërkohë që qyteti pësoi ndryshime radikale të transportit bazik publik, duhet thënë se ky i fundit mbeti në shumë raste jo eficient dhe problematik, duke kontribuar indirekt në stimulimin e transportit privat dhe rritjen e ndotjes së ajrit të qytetit në nivele shqetësuese. Projekti i tij i fundit për rehabilitimin e sheshit Skënderbej, ishte një përpjekje për të bërë një mbyllje dinjitoze, por të nxituar në prag të fushatës së zgjedhjeve lokale të fundit. Edhe pse, në thelb studio 54N1E solli një ide interesante, përfshi këmbësorizimin e sheshit Skënderbej, projekti bazohej në një koncept në formë piramidale, që ishte historikisht mjaft i kontestuar në Shqipëri, që ndërpriste vijimësinë lineare pamore të bulevardit. Ai nuk merte në konsideratë një terminal qëndror të transportit publik dhe e përkeqësonte situatën e transportit në mungesë të marrjes së masave të tjera, përfshi modernizimin e sistemit të unazave dhe plotësimin e një rrjeti rrugor të munguar prej 170 km rrugë dhe hapësirë publike, pa folur për mungesën totale të terminaleve të transportit publik.

Në përfundim, mund të thuhet se, dekada e viteve 2000 ka lënë padyshim në qytet vulën e modelit të qeverisjes Rama. Ai e mori qytetin në një situatë mjaft të vështirë dhe e dorëzoi në tërësi më mirë nga sa e gjeti, por absolutisht me një problematikë shumë më të komplikuar dhe më të rënduar se 10 vite më parë. Tirana, gjatë 10 viteve të qeverisjes së tij, u bë më interesante, më atraktive dhe më prezente në rajon e më gjerë, pa mohuar faktin që trashëgoi pikëpyetje të qytetit, paqartësitë mbi të ardhmen e qytetit në lidhje me furnizimin me ujë, pastrimin e ambienteve urbane dhe shërbimeve të transportit publik. Por, ai do të konsiderohet si një reformator dhe ndryshues i pamjes së jashtme të Tiranës, duke humbur shansin e madh për ta atakuar vetë thelbin e qytetit.

Sfidat e Projektit “Tirana jeni ju”

Pas "dekadës Rama" zgjedhjet e fundit vendore, në 8 maj 2011, do të mbahen mend gjatë për rezultatin mjaft të ngushtë. Rezultati i tyre u nda pothuajse i barabartë duke rezultuar në fund me një proces të ngarkuar politikisht dhe emocionalisht, për shkak të një diferencë me 100-150 vota. Kjo fitore, në pamje të parë e “ngushtë” e Projektit “Basha”, në fakt nuk ishte e tillë... Ky projekt, jo vetëm që rikuperoi rreth 20,000 vota që Projekti “Ti-Rama” kishte marrë mbi Projektin “Olldashi” në 2007, por Platforma “Tirana jeni ju!” arriti të gjenerojë besim dhe dëshirë për ndryshim tek qytetarët. Por, pas këtij rasti unikal për demokracinë e re shqiptare,

tashme përpara Lulzim Bashës, kryetarit të ri të Bashkisë së Tiranës, shtrohen disa sfida krahasueshmërisht të ngjashmë me ato të Edi Ramës në vitin 2000.

Sfida e parë është pikërisht nevoja për të atakuar thelbin e qytetit, i cili siç u tha më lart shoqërohet me një problematikë gjithnjë e më të komplikuar dhe më të vështirë. Atakimi i parë i këtij thelbi në mënyrë serioze është realizimi imediat i një plani urbanistik, i cili i paraprin zhvillimeve të qëndrueshme ekonomike dhe sociale dhe jo siç është vepruar deri më sot, ku plani është sabotuar qëllimisht. Basha ka premtuar, se do ta plotësojë këtë objektiv brenda vitit të parë të mandatit të tij të parë. Sidoqoftë, këtu nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete miratimi i planit, sesa hartimi i një dokumenti të vlefshëm dhe transparent e gjithëpërfshirës, ku të balancohen sa më mirë interesat individuale - komunitare, si nga pikëpamja sociale, ashtu edhe ekonomike, e për më tepër larg debatit të panevojshëm të politizuar ekstremisht.

Sfida e dytë, Basha duhet të adresojë nevojën për përmirësimin e aksesit si në pjesët tradicionale dhe të reja të qytetit, përfshi hapjen e rrugëve të reja radiale dhe unazore, si dhe lidhje më të mirë me komunat dhe bashkitë fqinje. Kjo e fundit imponon nevojën për ndërtimin e një mirëkuptimi politik dhe administrativ me njësitë vendore fqinje, në dy nivele: i) *Tirana e Madhe* (ku përfshihen veç Tiranës edhe Kamza, Paskuqani, Dajti, Farka, Kashari), dhe ii) *Rajoni Metropolitan* (që përfshin njësitë vendore në hapësirën territoriale midis Durrësit, Krujës e Tiranës, dhe së fundi me ndërtimin e autostradës edhe

Elbasani). Pa ndërtimin e një autoriteti metropolitan do të jenë të pamundura të ideohen dhe zbatohen projekte serioze, të cilët e modernizojnë kryeqytetin shqiptar si çdo kryeqendër tjetër europiane.

Sfida e tretë e rëndësishme e Bashës, zbatimi i një sistemi të transportit publik të integruar dhe multimodal, bëhet urgjente për shkak të trafikut dhe ndotjes gjithnjë në rritje të Tiranës. Basha ka premtuar ndërtimin e unazës së re, nisjen e sistemit të tramvajit dhe ndërtimin e stacioneve multimodale e të parkimeve. Por, kjo kërkon që ai të ndërgjegjësohet politikisht për nevojën e vizionimit të Bashkisë Tiranë, përtej kufijve të saj administrative dhe në koordinim me shumë aktorë dhe institucione të tjera. Këto masa duhen shoqëruar nga një sërë veprimesh energjike në përgjigje të nevojave komunitare, siç janë risjellja e gjelbërimit dhe parqeve urbane, ngritja e infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimit për mbetjet urbane, ujin e pijshëm, shërbimet sociale, jetën kulturore apo investimi për marketimin dhe brandimin e Tiranës si një qytet normal europian dhe një destinacion atraktiv-turistik dhe ekonomik.

Mbi të gjitha sfida e Bashës mbetet sjellja e një dimensionit të ri urban dhe social në Tiranën, që tashme duhet se po e kalon fazën e plotësimit të nevojave bazë dhe që duhet të ofrojë mundësi në rritje për qytetarët e vet.

Sfida vazhdon... dhe mbetet për t'u monitoruar...



Konkursi për masterplanin e zonës qendrore të Tiranës, 2004
 Pjesë nga projekti fitues i konkursit i paraqitur nga "Architecture Studio", Francë



Konkursi për sheshin "Skënderbej", 2008. Pjesë nga varianti i projektit të ATENASTUDIOS, Itali



Konkursi për sheshin Skënderbej, 2008. Pjesë nga varianti i projektit të ATENASTUDIOS, Itali



Konkursi për sheshin "Skënderbej", 2008. Pjesë nga varianti i projektit të Daniel Libeskind, US



Konkursi për sheshin "Skënderbej", 2008. Pjesë nga varianti i projektit të MVRDV, Hollandë




Konkursi për sheshin "Skënderbej", 2008. Pjesë nga varianti i projektit të 51N4E, Belgjikë, (varianti fitues)



Konkursi për sheshin "Skënderbej", 2008. Pjesë nga varianti i projektit të Architecture Studio, Francë

Konkursi për Kullën në kryqëzim të rrugës së "Durrësit" dhe të "Kavajës"





Erik van Egeraat Architects



Konkursi për Kullën në kryqëzim të rrugës së "Durrësit" dhe të "Kavajës". Henning Larsens Tegnestue a/s; projekti fitues



Konkursi për Kullën në kryqëzim të rrugës së "Durrësit" dhe të "Kavajës"
 MAP Architects & Josep A Acebillo





Konkursi për kullën në krah të
 Parlamentit (TID tower)
 51N4E (projekti fitues; në fazën
 përfundimtare të realizimit)



Archea Studio




Bolles & Wilson




Bolles & Wilson


Konkursi për kullën në krahë të Gjykatës së Lartë, Bolles & Wilson



Bolles & Wilson



Konkursi për kullën në krahë të Gjykatës së Lartë, Archea Studio (projekti fitues; në realizim e sipër)



Archea Studio



Xaveer de Geyter




Xaveer de Geyter

Xaveer de Geyter





Xaveer de Geyter



Xaveer de Geyter

Konkursi për kullën në krahë të gjykatës së lartë, Xaveer de Geyter



Konkursi për kompleks urban në krah të Parlamentit
 MVRDV (projekti fitues; në realizim e sipër me ndryshime; projekti që po realizohet i përpunuar përsëri nga MVRDV paraqitet në faqet 110-111 në rubrikën "made in/for Albania" – Toptani shopping center)

Konkursi për kompleks urban në krah të Parlamentit
 Mario Bellini Associati


P U B L I C R O O T



Konkursi i parë për Parlamentin e Republikës së Shqipërisë, (2006). Mario Campi dhe Fabio Reinhardt, Zvicer projekti fitues (i anuluar).





Konkursi i dytë për Parlamentin e Republikës së Shqipërisë (2011). Coop Himmelb(l)au, Austri; projekti fitues



Konkursi i parë për Parlamentin e Republikës së Shqipërisë. Varianti i paraqitur nga Coop Himmelb(l)au, Austri





Konkursi për Xhaminë e Tiranës (2011)
Bjarke Ingels Group - BIG (projekti fitues)





Për çfarë duhet një arkitekt ?!

nga Elvan Dajko

Abstract

This article intends to bring forward a series of reflections over architecture, its role in the society and the guiding principles in the design process. Starting from the title it actually states the duplicity among an architect's features and values and his questionable role in the society, questionable referred to the actual deprivation from these very values. The genesis of such occurrence is the Albanian context and architecture, when even after two decades from the regime shift that brought the awaited freedom, haven't succeeded in forming a specific architectural character. The article focuses on several key issues such as the relation of the architect with the context, with the character of the edifice, with sustainability, and so on. Whilst, it also intends to provide a parallelism among the Albanian context in terms of architecture as a discipline and the architect himself. The aim, more than a reflection on contemporary architectural theories, is to initiate a critical approach, not necessarily negative, on Albanian architecture and foremost on its future development.

Ky artikull është një përpjekje për të sjellë një sërë reflektimesh mbi arkitekturën, rolin e saj shoqëror dhe një sërë parimesh që supozohet të drejtojnë procesin e projektimit. Natyrisht nuk bëhet fjalë për teorizim personal, pasi rëndësi të veçantë i jepet njohurisë dhe eksperiencës kolektive referuar historisë dhe teorisë së arkitekturës. Në të njëjtën kohë synohet, aty ku është e mundur, të bëhet paralelizëm me kontekstin shqiptar për të parë dhe kuptuar sado pak sa arkitekti shqiptar është në gjendje apo zotëron pikërisht këto parime të dala nga eksperiencia dhe idetë e vetë historisë së disiplinës së arkitekturës. Nga vetë titulli kuptohet se arkitektura dhe figura e arkitektit është duke kaluar një fazë tranzicioni mjaft të fortë, duke vënë në dyshim në mënyrë serioze edhe rolin e tij ndaj shoqërisë, fakt ky mbarëbotëror, por ndoshta më i qartë në kontekstin shqiptar.

Prej kohësh arkitektura konsiderohet si disiplinë në kufijtë e shkencës dhe artit, duke i dhënë objektivitetit shkencor të procesit të projektimit arkitektonik vlerë subjektive,

shpesh herë edhe arbitrare.

Për më shumë se një shekull, tashmë në një linjë edhe me mendimin e Walter Gropius¹, arkitekti bashkëkohor, si një person i cili duhet të përballet me problemet realiste, si ato sociale, ekonomike, politike, teknike, formale duhet domosdoshmërisht të qartësojë raportin ndërmjet eksperiencës kolektive si përvojë e shoqërisë gjatë historisë, projektit arkitektonik dhe ndërtimit.

Përpara se të bëjmë paralelizmat e premtura më lart, duhet të qartësojmë më parë zhvillimet e Shqipërisë në dy dhjetëvjeçarët e fundit për të kuptuar apo “justifikuar” sado pak “arkitekturën e re”.

Me vendosjen e regjimit socialist, një nga detyrat kryesore të shtruarra ishte ajo e zgjidhjes së problemit të strehimit. Falë politikave sociale dhe ideologjike, kjo kërkesë ka qenë deri diku e plotësuar, por mund të flitet vetëm për sasi, duke iu referuar standarteve të kohës dhe më pak për cilësi. Përsa i përket arkitekturës në periudhën socialiste

mund ta konsiderojmë si funksionaliste pasi koncepti bazohej në funksion dhe në nevojat bazë duke menduar se ishte pikërisht kjo metodë e cila mund t'i jepte procesit të projektimit një objektivitet të tillë për ta transformuar atë në një proces "shkencor". Kjo metodë çonte gjithsesi në zgjidhje formale dhe ishte mjaft e vështirë të gjendej një referencë ndaj të cilës të kontrollohen përgjigjet dhe risitë arkitekurore të kohës.

Dështimi i sistemit socialist në Shqipëri, si në terma politike, ekonomike dhe shoqërore, solli periudhën e vështirë të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut dhe konsolidimit të demokracisë. E gjithë kjo u shoqërua me lindjen dhe zhvillimin e një sërë fenomenesh sociale dhe ekonomike shumë komplekse, të cilat lidhen me sistemin e pronësisë, urbanizimin me ritme rritjeje të jashtëzakonshme, kontrollin mbi territorin, tendencën e braktisjes së zonave rurale për të lëvizur në qendrat më të zhvilluara urbane, e kështu me rradhë.

Këto fenomene ishin rezultat i shkaqeve të shumta: (I) kërkesa e lartë për banesa,

(II) rritja e kërkesës për cilësi më të mirë të jetës, e cila në objektet ekzistuese nuk mund të ofrohej; (III) pamundësia e shtetit për të ofruar strehim ndaj kërkesës së lartë, (IV) mungesa e kontrollit mbi territorin dhe menaxhimin të tokës nga shteti, (V) zhvillimi ekonomik i tregut të lirë.

Karakteristikat kryesore e urbanizimit të qyteteve janë rritja e shpejtë e vendbanimeve apo zonave industriale të reja në zonat periferike apo afër periferive të qyteteve dhe dendësia e pjesës së brendshme të qytetit.

Arkitekti dhe shoqëria

Shpesh problemet dhe ndikimet e arkitekturës mbeten të ankoruara në ndërgjegjën e publikut. Qëkur arkitektura bashkëkohore u kthye në një stock ndërtesash pa fytyrë dhe identitet, ekspertiza e arkitektëve është vënë në pikëpyetje nga ana e publikut, madje dhe nga vetë profesionistët. Një fenomen ky, pothuajse normal duke pasur parasysh se përdorimi i parashikuar për hapësirat e projektuara shpesh rezultoi nga ana e për-

Arch. Elvan Dajko is an Architect who graduated from the Sapienza University of Rome - Faculty of Architecture, Italy. He does continuous research concerning architecture and housing in Albania, starting from his diploma thesis and further developed in the Master of Advanced Studies in Architecture, Specialization in Housing, a Postgraduate Program at ETH Zurich. Currently, he continues to develop this topic in his PhD program in Architecture and Construction - Space and Society at the Faculty of Architecture of the Sapienza University of Rome. Before becoming part of POLIS staff, in September 2010, he has been part of ATENASTUDIO - Rome, and afterwards has been involved in other collaborations with several studios in Italy, Switzerland and Albania. His professional activities include participation in various researches, project design, workshops and lectures with international and Albanian lecturers and also organizational tasks at an administrative level at POLIS University.

¹ GROPIUS W., Architetture integrata, Milano, Mondadori, 1959

doruesve si i papërshtatshëm².

Kërkesat që bien mbi arkitekturën bëhen gjithnjë e më komplekse. Përgjigja nga ana e arkitektëve shpesh kritikohet si tepër akademike, me një parim didaktik të reduktuar vetëm mbi një perceptim pamor të arkitekturës, e cila vendos pak vëmendje në qëllimin e vërtetë, duke u kthyer pothuajse në fosilizimim e barokut, që ekzistonte deri në fillimet e 900' dhe ku ndërtesa nuk ka të bëjë shumë me karakteristikat funksionale dhe qëllimin për të cilin ajo është projektuar³.

